



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, vizitë zyrtare në Pentagon

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, gjatë vizitës së tij zyrtare në SHBA, u prit në Pentagon nga sekretari amerikan i Mbrojtjes Lloyd J. Austin III. Bisedimet e tyre u fokusuan në vazhdimin e bashkëpunimit strategjik të Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë si dhe në forcimin e dialogut politik.

Sekretari Austin dhe ministri Peleshi diskutuan për ndihmën që iu dha Shqipërisë nga Garda Kombëtare e New Jersey-t pas sulmit kibernetik dhe ranë dakord të vazhdojnë të punojnë së bashku për të forcuar edhe më shumë aftësitë e mbrojtjes kibernetike të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë. Ministri i Mbrojtjes Peleshi shprehu falënderimet për

mbështetjen e menjëhershme që dhanë ekipet e specializuara amerikane të mbrojtjes kibernetike, ndërsa shprehu nevojën që mbështetja e SHBA-ve të jetë më e zgjeruar edhe për sistemet e tjera në vend, veç atyre të Ministrisë së Mbrojtjes. Gjatë bisedës, Ministri Peleshi e konsideroi vitin e kaluar, vit rekord sa i përket projekteve të... » faqe 3



SIGURIA KOMBËTARE PËR VITIN 2023

Prioritet, procesi i rishikimit dhe hartimit të dokumenteve strategjike



Strukturat e Forcave të Armatosura, angazhim maksimal për përballimin e situatës së krijuar nga reshjet

Sgjenden të angazhuara pranë popullsisë civile të prekur nga përmbytjet, si rrjedhojë e reshjeve të dendura të shiut në ultësirën veriperëndimore të vendit. Dy nga strukturat kryesore të FARSH-së, Forca Tokësore dhe Komanda e Mbështetëse, prej afro një jave, kanë qëndruar në krah të popullsisë civile të zonës së Shkodrës dhe Lezhës. Mbi 50 trupa me mjete të kalueshmërisë së lartë kanë punuar këto ditë për të ndihmuar banorët e izoluar nga uji në fshatin Obot, Shkodër. Ndërkohë, forca dhe mjete nga...



» Faqe 2

Historiku i Ushtrisë Shqiptare, art, mbrojtje, sakrificë sublime, krenari kombëtare

Intervistë me ish-zëvendësmministrin e Mbrojtjes dhe ish-zëvendëshefin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, z. **BAJRAM MANA**

Bajram Mana u lind më 10 nëntor 1944 në Librazhd. Në vitet 1958-1962 përfundoi shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej". Në 1964 diplomohet me rezultate të shkëlqyera në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Kryen detyra në të gjitha nivelet, si komandant kompanie, batalioni e shef stërvitjeje Brigade. Në 1974 përfundoi Akademinë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm...



» Faqe 6-7

104 vjet nga vdekja e "Atit të Pavarësisë", Ismail Qemali

104 vite më parë, më 24 janar 1919 kaloi në përjetësi, për të hyrë dhe qëndruar në altarin e pavdekshmërisë së kujtesës sonë kombëtare, personaliteti më i shquar shtetëror, diplomatik dhe shoqëror i lëvizjes kombëtare shqiptare, Babai i Pavarësisë, Themeluesi i shtetit shqiptar dhe figura më e dashur e karizmatike e shqiptarëve, Ismail Qemal Vlora. Ismail Qemal Vlora lindi më 24 janar 1844, në Vlorë në familjen e madhe të Vlorajve. Mbiemri i tij Vlora flet shumë për vendlindjen e tij, për qytetin, familjen e tij patriotike...



» Faqe 12

Prioritet, procesi i rishikimit dhe hartimit të dokumenteve strategjike

Presidenti i Republikës z. Bajram Begaj mbledhi Këshillin e Sigurimit Kombëtar me qëllim analizimin e gjendjes së sigurisë kombëtare dhe prioritetet për vitin 2023.

“Viti që lamë pas, ishte i vështirë dhe sfidues për sigurinë kombëtare. Sulmi kibernetik shkaktoi probleme në infrastrukturën digjitale. Në aspektin rajonal, pati përpjekje nga shtete me interesa jo-miqësore për frenimin euro-atlantik të tij”, - deklaroi në nisje të mbledhjes kreu i shtetit.

Në përfundim të mbledhjes së Këshillit të Sigurisë, Presidenti Bajram Begaj kërkoi që të trajtohen me prioritet procesi i rishikimit dhe hartimit të dokumenteve strategjike, Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, dokumenteve strategjike në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, emergjencave civile, si dhe strategjive sektoriale.

Pas raportimeve dhe diskutimeve në Këshillin e Sigurimit, Presidenti i Republikës Bajram Begaj e vlerësoi si shumë të rëndësishëm këtë takim dhe angazhimin e të gjitha institucioneve për garantimin e sigurisë kombëtare në fushën e tyre të përgjegjësisë. Presidenti theksoi si të rëndësishëm bashkërendimin, përpjekjet dhe sigurimin e gjithëpërfshirjes institucionale, përdorimit efikas të burimeve kombëtare dhe kërkimit të kontributit të çdo qytetari në funksion të sigurisë kombëtare.

Po ashtu presidenti Begaj kërkoi në takim që dokumentet strategjike nuk duhet të jenë thjesht dokumente formalë, duhet të jenë të mirëbuxhetuara dhe të sigurojnë përdorimin në mënyrë të koordinuar dhe harmonizuar të instrumenteve të fuqisë kombëtare në garantimin e sigurisë, të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, të rrisin mirëqenien e qytetarëve, dhe të sigurojnë mbrojtjen e vlerave dhe interesave kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Viti 2022 sfidues për sigurinë kombëtare

Në fjalën e tij, Presidenti u shpreh se viti që lamë pas ishte i vështirë dhe sfidues për sigurinë kombëtare. “Në muajin korrik, ne u përballëm me një nga sulmet më të rënda kibernetike të sponsorizuara nga struktura shtetërore të Republikës Islamike të Iranit, i cili jo vetëm shkaktoi probleme në infrastrukturën digjitale në vend, por ishte me qëllime të dukshme politike për të shkaktuar destabilitet”, - theksoi z. Begaj. Z. Begaj tha po ashtu se: “Gjatë vitit 2022 kemi kaluar situata të vështira që lidhen me përmbajtjet gjatë periudhës së dimrit, situatë e vështirë është krijuar dhe këto dy javët e fundit, si dhe zjarret gjatë periudhës së verës. Gjithashtu ka pasur cenim të sigurisë publike nga fenomene të kriminalitetit, aktivitete të paligjshme të trafikut të lëndëve narkotike, krimin të organizuar, korrupsionit, emigracionit etj.

Të gjitha këto kanë ndikuar negativisht në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve”.


Presidenti Bajram Begaj, në fjalën e tij gjithashtu ngriti si shqetësim ndikimin e huaj në rajon. Sipas tij, ka shtete jo miqësore që duan të kenë ndikimin e tyre në Ballkan. “Në aspektin rajonal ka patur zhvillime me ndikim direkt apo indirekt në ruajtjen dhe mbrojtjen e interesave tona kombëtare, ndërkohë që shtete me interesa jo miqësore, nëpërmjet instrumenteve të ndryshëm



janë përpjekur të zgjerojnë influencën e tyre dhe të frenojnë proceset integruuese euro-atlantike të vendeve të rajonit tonë”, - tha presidenti.

Më tej ai tha se lufta në Ukrainë ka shkaktuar pasoja në të gjithë botën, përfshirë dhe në vendin tonë. Për këtë

arsye është diskutuar mbi sigurinë ushqimore. “Agresioni i paligjshëm i Rusisë ndaj Ukrainës ka shkaktuar krizën më të madhe të sigurisë në hapësirën euro-atlantike, ndërsa efektet e tij në fushën ekonomike u shoqëruan me rritje të konsiderueshme çmimesh në



sektorin ushqimor dhe të energjisë të cilat kanë shtrenjtuar dhe vështirësuar jetën e qytetarëve. Prandaj në këtë takim, do bëjmë një analizë të gjendjes së sigurisë kombëtare dhe ajo ç’ ka është më e rëndësishme është të diskutojmë prioritet për vitin në vijim, në funksion të një angazhimi të plotë dhe gjithëpërfshirës të të gjitha institucioneve, për të siguruar bashkërendimin e përpjekjeve dhe përdorimin efikas të burimeve kombëtare në funksion të sigurisë, lirisë dhe mirëqenies”.

Një çështje tjetër mbi të cilën u ndal presidenti Begaj ishte situata në Kosovë, ku u shpreh se vendi ynë do të jetë në krah të Kosovës për të garantuar paprekshmërinë territoriale. “Përgjatë

gjithë vitit dhe në fund të dhjetorit të vitit të kaluar, u ballafaquam me një situatë tepër delikate në veri të Kosovës, e cila nuk kontribuon në paqen dhe stabilitetin rajonal. Shqipëria është në krah të Kosovës dhe vlerëson ruajtjen e paprekshmërisë dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, vlerëson rolin dhe kontributin e misionit KFOR të NATO-s në garantimin e paqes dhe sigurisë, respekton parimet e fqinjësisë së mirë, si dhe mbështet dhe inkurajon dialogun Serbi-Kosovë të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe mbështetur nga SHBA-të, për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare, që do të çojë në njohje të ndërsjellë”.

Strukturat e Forcave të Armatosura, angazhim maksimal për përballimin e situatës së krijuar nga reshjet

Strukturat e Forcave të Armatosura gjenden të angazhuara pranë popullsisë civile të prekur nga përmbajtjet, si rrjedhojë e reshjeve të dendura të shiut në ultësirën veriperëndimore të vendit. Dy nga strukturat kryesore të FARSH-së, Forca Tokësore dhe Komanda e Mbështetëse, prej afro një jave, kanë qëndruar në krah të popullsisë civile të zonës së Shkodrës dhe Lezhës.

Mbi 50 trupa me mjete të kalueshmërisë së lartë kanë punuar këto ditë për të ndihmuar banorët e izoluar nga uji në fshatin Obot, Shkodër. Ndërkohë, forca dhe mjete nga Forca Tokësore dhe Komanda e Mbështetëse, gjatë ditës së enjte dhe të premte janë përqendruar në Lezhë, në gatishmëri për të vepruar në rast të përkeqësimit të situatës. Gjithashtu, efektivet e Komandës Mbështetëse, ditën e enjte i janë gjendur pranë një familjeje në fshatin Rukaj, Mat, duke ngritur një çadër për strehimin e tyre, për shkak të dëmtimit të banesës nga tërmeti i disa ditëve më parë. Reshjet e dendura të shiut kanë sjellë përkeqësim të situatës edhe në Republikën e Kosovës. Për t’i ardhur në ndihmë vëllezërve matanë kufirit, Forcat e Armatosura vendosën në gatishmëri mbi 35 forca 6 mjete dhe një motobarkë, të cilat u përqendruan në Kukës në pritje të kërkesës për



ndërrhyrje.

Forca Tokësore, vijon edhe sot të këtë personel dhe mjete të angazhuara në Obot, Shkodër, ku edhe pse personeli është i reduktuar si rrjedhojë e përmirësimit të situatës, efektivet e batalionit të Parë të Këmbësorisë, vijojnë kontributin e tyre për transportin e banorëve të zonës, të cilët për shkak të nivelit ende të lartë të ujit, nuk mund të lëvizin nga dhe drejt banesave të tyre.

KM e angazhuar në operacione në ndihmë të komunitetit në zonat e përmbytura në qarkun Shkodër, Lezhë, Dibër

Efektivët e strukturave të Komandës Mbështetëse, kryesisht reparti ushtarak nr. 4040 (Batalioni Xhenios), janë angazhuar në kryerjen e rikonicionit për funksionimin e urës në fshatin Manati të Lezhës, zonë e cila është izoluar për shkak të dëmtimit të urës.

Në fshatin Rukaj, bashkia Mat, është bërë e mundur ngritja e një çadre në mbështetje të një familjeje, pasi banesa e të cilëve është dëmtuar nga tërmeti.

Operacion për transportim dhe shpërndarje ndihmash në qarkun Dibër në bashkitë Mat, Klos, Bulqizë dhe Peshkopi, në zonat e izoluar nga reshjet e dëborës.

Gjithashtu, është vendosur në gatishmëri DMR, Kukës si dhe një efektiv prej 30 vetash të BMEC për t’i ardhur në ndihmë autoriteteve lokale në Kosovë, në ndihmë të popullsisë e cila ka pësuar përmbajtje nga kushtet e këqija atmosferike.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, vizitë zyrtare në Pentagonon

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, gjatë vizitës së tij zyrtare në SHBA, u prit në Pentagon nga sekretari amerikan i Mbrojtjes Lloyd J. Austin III. Bisedimet e tyre u fokusuan në vazhdimin e bashkëpunimit strategjik të Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë si dhe në forcimin e dialogut politik. Sekretari Austin dhe ministri Peleshi diskutuan për ndihmën që iu dha Shqipërisë nga Garda Kombëtare e New Jersey-t pas sulmit kibernetik dhe ranë dakord të vazhdojnë të punojnë së bashku për të forcuar edhe më shumë aftësitë e mbrojtjes kibernetike të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë.

Ministri i Mbrojtjes Peleshi shprehu falënderimet për mbështetjen e menjëhershme që dhanë ekipet e specializuara amerikane të mbrojtjes kibernetike, ndërsa shprehu nevojën që mbështetja e SHBA-ve të jetë më e zgjeruar edhe për sistemet e tjera në vend, veç atyre të Ministrisë së Mbrojtjes. Gjatë bisedës, Ministri Peleshi e konsideroi vitin e kaluar, vit rekord sa i përket projekteve të përbashkëta me SHBA-të, duke përmendur këtu nisjen e punës për Bazën Taktike të NATO-s në Kuçovë, modernizimin e Forcës Ajrore me helikopterët "Black Hawk", si dhe projektet në edukimin ushtarak, etj.

Ministri Peleshi i prezantoi sekretarit amerikan të Mbrojtjes edhe projektin e portit të ri të Porto Romanos si dhe rëndësinë strategjike që ky port ka për rajonin, Evropën Juglindore dhe Aleancën e NATO-s. Gjithashtu theksoi angazhimin e vendit tonë për të



qenë faktor stabiliteti në rajon dhe më gjerë, ndërsa u shpreh se Kosova është interesi ynë strategjik kombëtar dhe ne e mbështesim aspiratën euroatlantike të Kosovës. Sekretari Lloyd J. Austin III falënderoi ministrin Peleshi për pritjen që Shqipëria i bëri Stërviçit "Defender Europe - 21" dhe të Brigadës së Ndihmës së Forcave të Sigurisë së Ushtrisë Amerikane. Sekretari Austin përgëzoi ministrin Peleshi për mbështetjen e palëkundur të Shqipërisë për Ukrainën, për angazhimin në NATO dhe përfshirjen në të gjitha operacionet e Aleancës.



Ministri Peleshi: Shqipëria do vazhdojë kontributin e saj drejt Ukrainës. Paketë tjetër donacionesh për Ukrainën

Ministri i Mbrojtjes, zoti Niko Peleshi mori pjesë në takimin e Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, që u zhvillua në Bazën Ajrore në Ramstein, Gjermani. Ky ishte takimi i tetë i ministrave dhe shefave të shtabit të mbi 50 vendeve të botës si dhe të Ukrainës që prej fillimit të agresionit rus ndaj Ukrainës. Takimi që u drejtua nga sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve z. Lloyd J. Austin III u fokusua në vijimin e ndihmës ushtarake për Ukrainën, si dhe çështjet e tjera të sigurisë, me të cilat përballen aleatët dhe partnerët e NATO-s. Gjatë fjalës së tij, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vlerësoi popullin ukrainas për kurajën dhe vendosmërinë e treguar si dhe lidhshirësinë e qeverisë, teksa po mbushet një vit që nga nisja e luftës. Gjithashtu, ministri Peleshi i shprehu ngushëllime ministrin ukrainas për jetët e humbura nga sulmet e fundit ruse ndaj popullit ukrainas. Më tej, ministri Peleshi përmendi kontributin që Shqipëria ka ofruar për Ukrainën, ndërsa njoftoi përgatitjen e një pakete tjetër të konsiderueshme mbështetjeje. Grupi i Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën (UDCG), është një iniciativë e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve, që mbledh së bashku aleatë dhe partnerë nga e gjithë bota, për të diskutuar mbi bashkëpunimin dhe sfidat e sigurisë që duhen përballuar si pasojë e agresionit rus në Ukrainë.



Atashetë ushtarakë të vendeve të NATO-s, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, vizitojnë AFA-në

Në kuadër të planit vjetor të Atasheve Ushtarakë, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, AU të vendeve të NATO-s vizituan AFA-në.

Ata u pritën nga komandanti AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri, i cili i njohti ata me zhvillimet e fundit të AFA-së. Në veçanti u theksua procesi i transformimit të AFA-së sipas modelit të Akademisë Amerikane "West Point", një prioritet që ka vëmendjen edhe të Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Mbrojtjes, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe që mbështetet edhe nga aleati strategjik SHBA. Gjeneral Bitri i falënderoi atashetë për mbështetjen që vendet e tyre kanë dhënë në drejtim të arsimit të oficerëve, ku aktualisht janë rreth 51 studentë që studiojnë në SHBA, Turqi, Itali, Gjermani, Greqi, Kosovë. Atashetë Ushtarakë vlerësuan arritjet e AFA-së dhe gatishmërinë për vijimin e bashkëpunimit ushtarak bilateral.



SHSHPFPA, takim me personelin nënoficer

Në sallën e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua takimi me shefin e Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji dhe personelin nënoficer kryekapter/kapter të FA-së. Në këtë takim u ndanë mendime, ide, si dhe këshillat për fuqizimin e rolit të nënoficerit si instruktor, planëzues stërvitjeje dhe ekspert i zoti në çdo fushë, përmes disiplinës, kërkesës për vetëzhvillim dhe punës profesionale të vazhdueshme. Të gjithë trupës së nënoficerëve, gjeneral brigade Kingji u shprehu falënderimet e tij për karakterin, integritetin dhe motivimin e fortë që ekziston mes tyre, duke treguar cilësitë më të mira në çdo stërvitje dhe angazhim, brenda dhe jashtë vendit.



Në ambientet e Auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua ceremonia e përfundimit dhe certifikimit të Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Në këtë ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, komandantë forcash dhe të njëjve autonome të FA-së, drejtorë të Shtabit të Përgjithshëm, atashu i Republikës së Kosovës i akredituar në Shqipëri, nënkolonel Enver Hoti, staf akademik e mbështetës si dhe pedagogë dhe kursantë.

Ceremonia u hap me fjalën e rastit të zëvendëskomandantit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Emëror Hajdarasi, i cili ndër të tjera theksoi se: “Kursi që sapo përfunduar përbën një ngjarje të shënuar në karrierën tuaj ushtarake. Qëllimi i tij ishte përgatitja dhe kualifikimi juaj për pozicione të ndryshme të shtabeve të reparteve, si dhe në shtabe të reparteve e nënreparteve shumëkombëshe të strukturave të NATO-s. I lumtur që në kurset institucionale që zhvillohen pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë marrin pjesë dhe do të vazhdojnë në vijim dhe përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës, duke

Përfundon Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit



sjellë eksperiencat dhe përvojat më të mira. Për tre muaj të kohëzgjatjes së këtij kursi, ju kuptuat më mirë mënyrën se si shtabi kryen misionin e tij, jeni bërë më të aftë në përmbushjen e kërkesave të drejtimit komandimit dhe të stërvitjes. Ju përmbushët qëllimin e kursit me njohuritë e fituara gjatë zhvillimit të kurrikulës mësimore dhe tani do të ndiheni më komod në realizimin e detyrave tuaja si oficerë shtabi në nivel batalioni”. Në përfundim të fjalës së tij ai falënderoi kursantët për korrektësinë, përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar në realizimin e programit, stërvitjes dhe vizitave të zhvilluara në njësitë e Forcave tona të Armatosura.

Në vijim, në emër të kursantëve përshëndeti kapiten Zaje Osma, e cila uroi kolegët për përfundimin me

sukses të kursit, duke u shprehur: “Gjatë kësaj periudhe, kuptuam se të qenit pjesë e këtyre auditorëve kërkon shumë përpjekje dhe përkushtim, për të përvetësuar e asimiluar programin arsimor me rezultate sa më të larta, me qëllim përparimin në gradë dhe vijimin me sukses të karrierës tonë ushtarake”. Në fjalën e saj ajo falënderoi pedagogun përgjegjës, stafin akademik dhe zëvendëskomandantin e kolegjit për të gjithë mbështetjen e vëmendjen gjatë procesit mësimor, duke e bërë më të lehtë zhvillimin e kursit.

Më pas përshëndeti shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, i cili pas falënderimit për përfundimin me suksese të kursit veçoi se mjedisi i sigurisë sot kërkon ndryshim të shpe-



jtë të vendimmarrjeve, prandaj duhet punuar fort për plotësimin e kurrikulës mësimore me informacionet më të fundit. Më tej gjeneral brigade Kingji do vijonte: “Me mbarimin e këtij kursi ju jeni në gjendje të organizoni nesër punën tuaj si leadership, në shtab apo në përfaqësi të ndryshme jashtë Republikës së Shqipërisë. Ju siguroj se bashkëpunimet me Forcat

e Sigurisë së Kosovës do të jenë të vazhdueshme dhe në qendër të vëmendjes tonë.”

Ceremonia u mbyll me shpërndarjen e certifikatave dhe me fotografi të përbashkët me kursantët, stafin akademik, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, komandantë e drejtorë.

Zhvillohet ceremonia e përfundimit të Kursit XVIII “Komando”

Në ambientet e Regjimenteve të Operacioneve Speciale (ROS), u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit XVIII “Komando”, ku ndër të tjerë merrnin pjesë: zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Arben Zani, atashu ushtarak i Republikës së Kosovës në vendin tonë, major Enver Hoti, komandantë të reparteve vartës të FT etj. Aktiviteti u hap nga komandanti i ROS, nënkolonel Ajet Jata, i cili theksoi se: “Përgjatë 14 javëve stërvitje, me fokus në taktikat “komando”, përgatitje zjarri, drejtimit trupash, alpinizëm, topografi, përgatitje fizike etj., me plot bindjen ju



themi se aftësitë e çdo kursanti tashmë janë të ndryshme nga aftësitë e çdo ushtaraku tjetër”.

Një falënderim dhe përgëzim të veçantë, komandanti i ROS adresoi edhe për kursantët nga Republika e Kosovës, të cilët treguan përgatitje dhe formim të lartë ushtarak gjatë kursit.

Ceremoninë e përshëndeti edhe zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, i cili pasi përgëzoi kursantët për këtë arritje në karrierën e tyre, ndër të tjera tha: “...përfundimi i çdo lloj kursi, është për ne ushtarakët një tullë më tepër në murin e karrierës tonë, por përfundimi i një kursi të tillë, siç është kursi “komando”, të cilët ju arritët ta përfundoni me sukses, është një krenari e shtuar për vetë faktin se

jo të gjithë janë të aftë të marrin iniciativë të tilla të guximshme, për t’iu nënshtruar ngarkesës së madhe psikologjike dhe fizike, që parashikon programi stërvitor i këtij kursi. Duhet të ndiheni krenarë, që pas kaq sakrificash të mëdha ju treguat se mund t’ia dilni. Vendosmëria, disiplina dhe shpirti i sakrificës që ju treguat, duhet të jetë shembull edhe për ushtarakët e tjerë, jo vetëm të Forcës Tokësore, por të të gjithë Forcave të Armatosura. Forca Tokësore është krenare gjithashtu që ka në mesin e saj njerëz të kalibrit tuaj të përgatitur dhe të gatshëm për t’u përballur me çdo sfidë...”

Të pranishmit në ceremoni, patën rastin të shikojnë nga afër nëpërmjet stacioneve stërvitore, disa demonstrime nga taktikat “komando”. Ceremonia u mbyll me betimin “komando” dhe me vendosjen e beretës blu.

Kursantët e Kursit Bazë të Oficerit në Qendrën Stërvitore, gjatë zhvillimit të temës “Kontroll turmash”, treguan përkushtim dhe interes të lartë në përvetësimin e programit trajnues.



“Junior Command and Leadership Course” po zhvillohet në Forcën Tokësore, nën drejtimin e instruktorëve britanikë, të British Military Advisory Training Team (BMAT), synon rritjen e aftësive profesionale, në fokus ato të leadershipit ushtarak të rolit bazë oficer dhe nënoficer.



Iniciativa për të rritur aksesin në të dhënat e imazherisë mjekësore të lidhur me kancerin

Komisioni Evropian prezantoi një iniciativë evropiane për imazherinë e kancerit në një ngjarje hibride. Nisma është pjesë e "Planit të Evropës për të mposhtur kancerin" dhe synon të promovojë aksesin, përdorimin dhe ndarjen e të dhënave të imazhit të kancerit, të cilat aktualisht janë të shpërndara, për të gjithë palët e interesuara.

Nisma, një veprim kryesor në kuadër të Planit të Evropës kundër Kancerit, do të punojë drejt krijimit të një infrastrukture dixhitale që lidh burimet dhe bazat e të dhënave të imazhit të kancerit në të gjithë BE-në, duke siguruar njëkohësisht respektimin e standardeve të larta të etikës, besimin, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ai gjithashtu do të lidhë iniciativat e nivelit të BE-së dhe ato kombëtare, rrjetet spitalore, si dhe depot e kërkimit me të dhëna imazherike dhe të dhëna të tjera përkatëse shëndetësore.

Inovacioni teknologjik që kombinohet me mbrojtjen e të dhënave mund të krijojë një kornizë të besueshme për studiuesit, novatorët, mjekët dhe pacientët. Falë Iniciativës së re Evropiane për Imazhe të Kancerit, studiuesit do të kenë akses efikas në më shumë të dhëna me cilësi të lartë për të studiuar dhe avancuar të kuptuarit tonë për sëmundjen. Inovatorët do të jenë në gjendje të zhvillojnë dhe testojnë zgjidhje të bazuara në të dhëna për kujdesin ndaj kancerit. Lehtësimi i zhvillimit të zgjidhjeve të bazuara në të dhëna do t'i lejojë



mjekët të marrin vendime klinike më të sakta dhe më të shpejta, diagnostikime, trajtime dhe mjekësi parashikuese, në dobi të pacientëve me kancer. Për më tepër, ai do të mbështesë altruizmin e të dhënave nga qytetarët, të cilët mund të japin pëlqimin ose lejen e tyre vullnetarisht për të vënë në dispozicion të dhënat që ata gjenerojnë, si një mënyrë për të pasuruar grupet e të dhënave shëndetësore.

Një infrastrukturë ndërkuftare, e ndërveprueshme dhe e sigurt që do të ruajë privatësinë do të përshejtojë inovacionin në kërkimin mjekësor.

Për shembull, do të jetë e mundur të

trajnohen teknologji të reja që përdorin inteligjencën artificiale në një bazë të dhënash të madhe, e cila është e standardizuar dhe plotësisht në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR). Kjo do të përshejtojë zhvillimin e mjeteve inovative, të cilat mund të ofrojnë diagnozë më të shpejtë të kancerit dhe kujdes të përmirësuar të personalizuar.

Komisionerja Stella Kyriakides nëpërmjet një video-mesazhi, në ngjarjen e nisjes së Iniciativës Evropiane për Imazhet e Kancerit, u shpreh se: "Teknologjitë dixhitale po ndryshojnë të kuptuarit tonë se si zhvillohet kancerin, po përmirësojnë

mundësitë tona për diagnozë të hershme dhe janë duke rritur njohuritë tona se si të trajtojmë më mirë pacientët.

Teknologjitë si Inteligenca Artificiale, ende ofrojnë potencial të madh, të pashfrytëzuar për të vazhduar ofrimin e përfitmeve të jashtëzakonshme në shëndet - veçanërisht kur bëhet fjalë për zbulimin, trajtimin dhe kujdesin e kancerit. Ajo u shpreh se angazhimi për të investuar dhe për të shfrytëzuar sa më mirë këtë potencial reflektohet në Iniciativën Evropiane për Imazhe të Kancerit.

"Jam e lumtur që jam pjesë e nisjes së kësaj nisme kryesore në kuadër të Planit të Evropës për të mposhtur kancerin dhe dëshiroj të falënderoj Komisionerin Breton për mbështetjen e tij për zgjidhjet inovative të kancerit dixhital. Është një iniciativë e cila është e lidhur ngushtë me Skemën e re të BE-së për depistimin e kancerit, e cila shënon një moment historik të ri në përpjekjet e shqyrtimit në nivel të BE-së. Është shembulli më i fundit se si Plani i Kancerit jep rezultate që mund të sjellin përfitime të mëdha për qytetarët.

Për herë të parë, ne kemi vendosur një objektiv ambicioz: t'u ofrojmë akses në depistimin e kancerit të gjirit, qafës së mitrës dhe kolorektalit për 90% të evropianëve të kualifikuar.

Ekzaminimi rutinë është çelësi për zbulimin e hershëm që në fund mund të

shpëtojë jetë.

Duke iu përgjigjur fushatës sonë për rritjen e ndërgjegjësimit që u bën thirrje të gjithë evropianëve të pranojnë ftesat për ekzaminim, një i mbijetuar nga kanceri tha se, nëse ekzaminimi do të kishte qenë i disponueshëm për të disa vite më parë, ai mund të mos kishte zhvilluar kancerin e zorrës së trashë në fazën e katërt.

Ky është vetëm një shembull nga të shumtët që duhet të shkojmë akoma më tej. Rekomandimet tona janë që gradualisht të sillen depistimi për mushkëritë, prostatën dhe, në rrethana të caktuara, kancerin e stomakut, bazuar në kërkime të mëtejshme".

Këto gjashtë lloje kanceri përbëjnë mbi gjysmën e të gjitha rasteve të kancerit dhe vdekjeve nga kanceri në BE.

Ndërsa udhëzimet evropiane dhe skemat e sigurimit të cilësisë përditësohen, përdorimi i testeve të reja të shqyrtimit të bazuara në prova do të rafinohe më tej.

Një rol të madh në këtë do të luajë Iniciativa Evropiane për Imazhet e Kancerit. Ajo do të sigurojë burime të vlefshme dhe biblioteka imazherish për palët e interesuara nga fusha klinike, nga kërkimi dhe inovacioni.

Është pikërisht kjo qasje në informacion që mund të çojë në zhvillimin e gjeneratës së ardhshme të diagnostikimit dhe trajtimit të kancerit.

Euro dixhitale: Paratë tona kudo, kurdo që na duhen

Hetimi ynë për një euro dixhitale filloi më shumë se një vit më parë.

Përfshirja e ngushtë e Parlamentit Evropian në fazën e hetimit ka qenë një prioritet për BQE-në që nga dita e parë.

Gjatë vitit 2022, ne diskutuam rregullisht opsionet kryesore të projektimit në këtë Komitet.

Sjellja e pagesave të njerëzve po ndryshon me një shpejtësi të paprecedentë: gjatë tre viteve të fundit, pagesat me para në dorë në zonën e euros kanë rënë nga 72% në 59%, me pagesat dixhitale, duke u bërë gjithnjë e më popullore.

Në Holandë dhe Finlandë, për shembull, paratë në dorë përdoren vetëm në një të pestën e transaksioneve. Në të njëjtën kohë, njerëzit vlerësojnë mundësinë për të paguar me para publike. Shumica e shohin si të rëndësishme ose shumë të rëndësishme të kesh gjithmonë atë zgjedhje.

Një euro dixhitale do t'i përgjigjej kësaj preference në rritje për pagesat elektronike, duke vënë në dispozicion paratë publike edhe në formë dixhitale.

Së bashku me paratë e gatshme, një euro dixhitale do t'u ofronte evropianëve akses në mjetet e pagesës që i lejojnë ata të paguajnë kudo në zonën e euros, pa pagesë. Të qenit lehtësisht i aksesueshëm dhe i përshtatshëm për t'u përdorur do të mbështeste adoptimin dhe përfshirjen financiare.

Një zgjidhje e përshtatshme pagese dixhitale, që u jep njerëzve kontroll mbi paratë e tyre

BQE është në ballë të përpjekjeve globale të bankave qendrore për të hartuar zgjidhje moderne të pagesave dixhitale për transaksionet me pakicë dhe me shumicë.

Pagesat janë pjesë përbërëse e jetës së përditshme: ne të gjithë zakonisht mbajmë të paktën një instrument pagese, qofshin ato monedha, kartëmonedha, një kartë krediti ose një telefon celular.

Prioriteti ynë për projektin e euros dixhitale ka qenë gjithmonë i qartë: ruajtja e rolit të parasë së bankës qendrore në pagesat me pakicë, duke ofruar një mundësi shtesë për të paguar me para publike, përfshirë këtu kur kjo nuk është



e mundur sot, për shembull në tregtinë elektronike.

Euroja dixhitale nuk do të zëvendësojë mënyrën të tjera pagese elektronike, apo në të vërtetë paratë në dorë. Përkundrazi, do t'i plotësojë ato. Dhe duke e bërë këtë, do të ruante sovranitetin tonë monetar duke forcuar autonominë strategjike të Evropës.

Publikimet fillestare do të fokusohen në mundësimin e aksesit në euron dixhitale për banorët e zonës së euros, përkatësisht konsumatorët, firmat, tregtarët dhe qeveritë.

Një euro dixhitale duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme dhe e përdorshme në të gjithë zonën e euros, si paratë e gatshme sot. Ne besojmë se kjo do të arrihej më së miri me një skemë dixhitale të euros.

Duke ofruar një grup të vetëm rregullash, standardesh dhe procedurash, një skemë do t'u mundësonte ndërmjetësve të zhvillojnë produkte dhe shërbime të ndërtuara mbi një euro dixhitale.

Skema do të sigurojë gjithashtu që qytetarët të kenë gjithmonë akses në disa shërbime thelbësore, pavarësisht se me cilin ndërmjetës kanë llogarinë ose portofolin e tyre.

Euro dixhitale do të ishte një e mirë publike. Prandaj do të kishte kuptim që shërbimet e tij bazë të jenë pa pagesë - për shembull kur përdorni euron dixhitale për të paguar një person tjetër, siç është

rasti për para në dorë.

Por, në krye të shërbimeve bazë, njerëzit mund të zgjedhin të përdorin çdo shërbim shtesë të ofruar nga ndërmjetësit pjesëmarrës mbi baza vullnetare.

Pagesat e kushtëzuara (ose të programueshme) përmenden shpesh si një shërbim i tillë inovativ - megjithatë, ka një konfuzion rreth termit dhe kjo mund të ngrejë shqetësime.

Përkufizimi ynë i pagesave të kushtëzuara është se njerëzit mund të vendosin të autorizojnë një pagesë automatike kur plotësohen kushtet e paracaktuara sipas zgjedhjes së tyre.

Për shembull: paguesi mund të vendosë të vendosë një pagesë mujore automatike në euro dixhitale për të paguar qiranë.

Por përfituesi nuk do të përballej me asnjë kufizim se çfarë mund të bëjë me këto para që marrin çdo muaj.

Ne besojmë se ndërmjetësit e mbikëqyruar, të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me përdoruesit, janë në gjendje më të mirë për të identifikuar rastet e përdorimit për pagesat e kushtëzuara dhe çdo shërbim tjetër të avancuar të pagesave.

Por më lejoni të jem i qartë: euro dixhitale nuk do të ishte kurrë para e programueshme. BQE nuk do të vendoste asnjë kufizim se ku, kur ose kujt mund të paguajnë njerëzit me një euro dixhitale. Kjo do të ishte e barabartë me një kupon. Dhe bankat qendrore lëshojnë para, jo kupona.

Ne jemi gjithashtu të vetëdijshëm për shqetësimet e disa njerëzve se një euro dixhitale mund të dëmtojë konfidencialitetin e të dhënave të tyre të pagesave.

Kur bëhet fjalë për bankën qendrore, ne propozojmë që të mos kemi akses në të dhënat personale.

Dhe do t'u tujë t'ujë juve, si bashkëligjvënës, të vendosni për ekuilibrin midis privatësisë dhe objektivave të tjera të rëndësishme të politikës publike, si kundër pastrimit të parave, kundër financimit

të terrorizmit, parandalimin e evazionit fiskal ose garantimin e respektimit të sanksioneve. Nga ana jonë, ne kemi punuar në zgjidhje që do të ruajnë privatësinë si parazgjedhje dhe sipas dizajnit, duke u dhënë kështu njerëzve kontrollin e të dhënave të tyre të pagesave.

Për këtë qëllim, ne jemi gjithashtu të angazhuar ngushtë me Mbikëqyrësin Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Bordin Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave.

Përdorimi i një euro dixhitale me lehtësi dhe kudo në zonën e euros

Si para publike, një euro dixhitale do të ishte një e mirë publike evropiane, në të cilën të gjithë qytetarët dhe firmat duhet të jenë në gjendje ta aksesojnë dhe ta përdorin pa barrierë. Ky duhet të jetë rasti pavarësisht se kush është ndërmjetësi i tyre ose në cilin shtet anëtar ndodhen.

Ofrimi i aksesueshmërisë dhe përdorshmërisë universale do të ishte çelësi për një euro dixhitale për të luajtur rolin e saj si një spirancë monetare dhe për të përmbushur pritshmëritë e njerëzve. Reagimet nga qytetarët pasqyrojnë vlerën e të paturit të një instrumenti pagese që është gjithmonë një opsion për paguesin. Qytetarët mund të mos paguajnë gjithmonë me para në dorë, por u pëlqen të kenë gjithmonë mundësinë për ta bërë këtë. E njëjta logjikë vlen edhe për një euro dixhitale.

Si bashkë-ligjvënës, ju mund të miratoni masa rregullatore që do të siguronin praninë të gjerë të euros dixhitale në pagesa, duke siguruar njëkohësisht që qytetarët të kenë akses të gjerë në euron dixhitale. Por ndërsa këta dy faktorë janë themelet jetike për euron dixhitale, ata vetëm nuk janë të mjaftueshëm. Funkcionalitetet tërheqëse dhe përvoja e përshtatshme e përdoruesit do të ishin po aq të rëndësishme për miratimin e gjerë.

Prandaj ne duam të dizajnojmë një euro dixhitale me funksione online dhe offline. Këto do ta lejojnë atë të shërbejë

raste të ndryshme përdorimi dhe t'u ofrojë përdoruesve përfitime të ndryshme. Për shembull, një funksion jashtë linje do t'u jepte pagesave një nivel privatësie që është afër atij të parave të gatshme. Do të rriste gjithashtu elasticitetin pasi do të funksiononte pa akses në internet.

Ne po parashikojmë gjithashtu dy opsione për përdorimin e përshtatshëm të një euro dixhitale.

Së pari, ndërmjetësit e mbikëqyruar mund të integrojnë euron dixhitale në platformat e tyre. Në këtë mënyrë, përdoruesit mund të aksesojnë lehtësisht euron dixhitale përmes aplikacioneve bankare dhe ndërfaqeve me të cilat tashmë janë njohur.

Së dyti, Eurosistemi po shqyrton një aplikacion të ri dixhital të euros, i cili do të përfshijë vetëm funksionet bazë të pagesave të kryera nga ndërmjetësit. Aplikacioni do të siguronte që pavarësisht se ku udhëtoni në zonën e euros, euro dixhitale do të njihet gjithmonë dhe ju do të mund të paguani me të.

Publikimet e para ka të ngjarë të ofrojnë pagesa pa kontakt, kode QR dhe një mënyrë të thjeshtë për të paguar në internet.

Ndërsa teknologjia evoluon, forma të tjera pagese mund të bëhen të disponueshme në të ardhmen. Kur bëhet fjalë për harduerin, njerëzit mund të paguajnë ose me telefona celularë, karta fizike ose ndoshta pajisje të tjera si orë inteligjente.

Një përvojë e përshtatshme përdoruesi kërkon bashkëpunim të ngushtë me të gjitha seksionet e tregut: grupet e konsumatorëve që dinë më mirë për nevojat e konsumatorëve; ndërmjetës që do të ofronin shërbime për klientët e tyre; dhe tregtarët që duan të ofrojnë një zgjidhje të përshtatshme pagese.

Ne kemi filluar punën për rregulloren e skemës dixhitale të euros për të siguruar një zgjidhje të harmonizuar dhe të përshtatshme për përdoruesit që funksionon kudo në zonën e euros.

Fabio Panetta, Anëtar i Bordit Ekzekutiv të BQE-së, në Komitetin për Çështjet Ekonomike dhe Monetare të Parlamentit Evropian

INTERVISTË ME ISH-ZËVENDËSMINISTRIN E MBROJTJES DHE
ISH-ZËVENDËSSHEFIN E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË USHTRISË, Z. BAJRAM MANA

INTERVISTOI
ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Bajram Mana u lind më 10 nëntor 1944 në Librazhd. Në vitet 1958-1962 përfundoi shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej".

Në 1964 diplomohet me rezultate të shkëlqyera në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Kryen detyra në të gjitha nivelet, si komandant kompanie, batalioni e shef stërvitjeje Brigade. Në 1974 përfundoi Akademinë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm. Emërohet komandant i Brigadës së 6-të të Këmbësorisë në Patos. Në 1975 emërohet zëvendës drejtor i Drejtorisë Operative të Shtabit të Përgjithshëm. Në vitet '78-'82, me vendim të Byrosë Politike, emërohet Komandant i Korpusit të Tretë në Korçë. Në vitet '82-'90, zëvendësministër i Mbrojtjes dhe zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë. Në 1990-1992, komandant i Divizionit të Parë në Tiranë. Për shërbime të shquara në Forcat e Armatosura, Bajram Mana dekorohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe mban tre urdhra e tre medalje.

Gjeneral Mana, ju dhatë kontributin tuaj të çmuar si ushtarak karriere, kur Ushtria Shqiptare ishte në lulëzimin e saj.

Sigurisht puna e gjithsecilit është matur me rezultatet e arritura dhe me gatishmërinë ushtarake të trupave që kam komanduar e drejtuar gjatë karrierës së gjatë ushtarake. Mua më ka rastisur të marr detyra të larta ushtarake qysh në moshën 30 vjeç, porsa përfundova Akademinë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm "Mehmet Shehu". Pastaj funksionet e detyrat e larta kanë ardhur hap pas hapi, deri në piramidën e komandimit të ushtrisë, duke u emëruar zëvendësministër i Mbrojtjes dhe zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, për 8 vjet me radhë, kur Ushtria Shqiptare ishte në kulmin e përgatitjes e të gatishmërisë së saj luftarake. Sigurisht edhe unë, si shumë kuadro të tjerë në atë periudhë të lavdishme kam dhënë kontributin tim të çmuar e të pakursyer, për forcimin e përgatitjen luftarake të njëjësive e reparteve operativo-strategjike të atdheut tonë të shtrenjtë, nga synimet grabitqare e armiqësore të armiqve tanë të mundshëm.

Dicka dua të theksoj për lexuesin tuaj, që në asnjë rast kontributin tim nuk e kam shkëputur apo ndarë nga kontributi i shumë e shumë kuadrove që kanë punuar me mua, që në vlerësimin tim ka qenë maksimal dhe domethënës në përgatitjen e gjithanshme të strukturave të mbrojtjes në interes të rritjes së forcës goditëse të llojeve të armëve dhe shërbimeve të ushtrisë tonë.

Si njohës i mirë i artit ushtarak, planit operativ, fushës së logjistikës, bilanc-furnizimit, financës dhe fortifikimit, me interes për lexuesin e shtypit ushtarak do ishte të dinim, si ishte ndërtuar struktura organizative, çfarë armësh dispononim dhe cilat ishin kapacitetet logjistike dhe ato të burimeve njerëzore?

Para se t'i përgjigjem kësaj pyetjeje me shumë përgjegjësi, dua t'ju falënderoj për zemërsisht, që pas 30 vjetësh, që unë jam nxjerrë në reformë nga ushtria, në moshën 48-vjeçare, mosha më produktive për të punuar, ne u hoqëm nga ushtrimi i profesionit, për të cilin

Historiku i Ushtrisë Shqiptare, art, mbrojtje, sakrificë sublimë, krenari kombëtare



investuam punë dhe mund pa kushte. Me qindra kuadro të aftë, me nga një e dy akademi, që u dhimbsej ushtria si familja e tyre. Masa drastike të gabuara, të cilat çuan në shpartallimin e ushtrisë shqiptare, në vitet e zeza 1997-1998.

Gjithsesi, ju shprehët interes të dini për strukturën organizative të ushtrisë në vitet '80-'90.

Struktura organizative e ushtrisë është themeli kryesor, ku çdo shtet mbështetet, për t'u mbrojtur nga një agresion i mundshëm i armiqve tanë potencialë. Prandaj, strukturës organizative të ushtrisë, Komanda e Përgjithshme, Këshilli i Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i kushtuan kujdesin maksimal. Të vendosje për strukturën organizative të ushtrisë duhej të bazohesh në tre elementë kryesorë: Së pari, forcën njerëzore që kishe në dispozicion; së dyti, teknikën dhe armatimin luftarak që disponoje; së treti, terrenin luftarak mbi të cilin do të vendosesh.

Forca njerëzore dhe armatimi e teknika luftarake

Mbi këtë bazë të rëndësishme, elita

udhëheqëse e Ministrisë së Mbrojtjes dhe e Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë organizuan, në vitin 1975, një rikonicion të hollësishëm nga jugu në veri të Shqipërisë, nga lindja në perëndim, me në krye, ministrin e Mbrojtjes, Mehmet Shehun, njëkohësisht dhe kryeministri i Shqipërisë; shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Veli Llakaj; Drejtori i Drejtorisë Operative, Hajrulla Muhameti; Zëvendës drejtori i Drejtorisë Operative, Bajram Mana; Drejtori i Xhenios dhe i Fortifikimit, Alfred Moisiu; Drejtori i Zbulimit i ushtrisë, Eqerem Osmani; Drejtori i Artilerisë, Sul Domi. Të domosdoshëm ishin edhe Komandanti i Korpusit dhe Oficeri i Drejtimit të Korpusit përkatës, në zonën ku zhvillohej rikonicioni.

Në rikonicion kishte rregulla të përcaktuara perfekte:

- Kaktoshin vijat kufitare midis korpusëve dhe mënyra e mbrojtjes së tyre;
- Zonat e desantimit ajror;
- Drejtimit e kundërmësymjes dhe e vendosjes së situatës;
- Drejtimit e mundshme të mësymjes së armikut;

- Vendkomanda dhe Pika e Drejtimit Operativ;
- Pozicionet kryesore të artilerisë tokësore të korpusit.

Pas këtij rikonicioni të hollësishëm, i cili do të shërbente si baza kryesore për hartimin e planit operativo-strategjik të mbrojtjes së vendit dhe e çdo plani operativ për çdo njësi e korpus në veçanti, u vendos një strukturë organizative:

- 7 korpusë këmbësorie;
- 2 grupime operative rezervë të Komandës së Përgjithshme dhe këto grupime në rang korpusi;
- Komanda e Mbrojtjes Kundërajrore, Tiranë;
- Komanda e Aviacionit Luftarak, Tiranë:
- Regjimenti Gjuajtës-Bombardues, Q. Stalin
- Regjimenti Gjuajtës-Bombardues, Rinas
- Regjimenti Gjuajtës-Bombardues, Gjadër
- Regjimenti i Helikopterëve Farkë
- Komanda e FLD-së në Tiranë:
- Komanda e Bazës Ushtarake Detare, Sarandë
- Komanda e Bazës Ushtarake Detare, Durrës
- Komanda e Bazës Ushtarake Detare, Shëngjin
- Komanda e Mbrojtjes së qytetit të Tiranës
- Komanda e ishullit të Sazanit
- Bazat e furnizimit të ushtrisë, Tiranë
- Bazat e furnizimit të ushtrisë, Elbasan
- Bazat e furnizimit të ushtrisë, Berat
- Bazat e furnizimit të ushtrisë, Rrëshen
- Bazat e furnizimit të ushtrisë, Tepelenë

3 brigada xheniere; 1 Brigada e Ndërlidhjes; 6 regjimente kundërtanke; 6 regjimente të Artilerisë Bregdetare; 1 Regjiment i Raketave Kundërajrore; 8 brigada të Rinisë Shkollore të Armatosur; 5 brigada të Rinisë Universitare; 6 brigada të FVVP; 76 brigada këmbësorie; 19 brigada sulmuese; 11 brigada tankesh; 13 brigada artilerie; 23 regjimente të Artilerisë Kundërajrore.

Kjo ishte afërsisht struktura organizative e ushtrisë. Duke pasur për bazë këtë strukturë, këtë armatim dhe këtë sasi njerëzore, u bë ose, u hartua me përgjegjësi të lartë shtetërore e ushtarake Plani Operativo-Strategjik i Mbrojtjes së Vendit, i miratuar nga Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Enver Hoxha. Pas Planit të Përgjithshëm, është hartuar për çdo korpus e brigadë plani operativo-strategjik për çdo njësi dhe mbi bazën e tyre ecte çdo vit njësi dhe reparti.

Për hartimin e këtyre planeve u harxhua shumë mund e djersë, të gjitha njohuritë ushtarake të fituara në shkolla

e akademi u vunë në shfrytëzim për hartimin me një nivel të lartë akademik e shkencor, me llogari e veprime të sakta të trupave si në mbrojtje ashtu edhe në mësymje.

Edhe arti i fortifikimit të rajoneve e brezave të mbrojtjes është organizuar e ndërtuar mbi bazën e këtyre planeve, të hartuar për çdo njësi e repart.

Kjo strukturë organizative rezistoi deri në vitin 1983. Pas vrasjes së Mehmet Shehut, ushtria shqiptare kaloi në një strukturë të re organizative, sidomos në njësitë e trupave të këmbësorisë, ndërsa llojet e armëve e të shërbimeve ngelën përsëri pothuajse ato që ishin edhe më parë.

Pra, nga viti 1983 e deri në vitin 1992, ushtria shqiptare kaloi nga korpuset e këmbësorisë, në divizione të këmbësorisë. Në këtë kohë ne kishim 22 divizione këmbësorie të shtrira në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sigurisht për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, kalimi në strukturën e re organizative me divizione, ishte një barrë tepër e rëndë. Pse? - Do të pyesni ju, me të drejtë. - Sepse, si sasi njerëzore po ato forca do të ishin.

Në fakt ashtu është, po ato forca do të ishin, por nga pikëpamja e organizimit, kompletimit, strehimit e akomodimit, për shumicën dërrmuese të divizioneve u parashikuan vendkomanda të reja, me të gjithë ambientet dhe aksesorët e nevojshëm për punë e jetesë, ato kërkonin fonde financiare dhe materiale ndërtimore. Çdo gjë ishte mbi bazën e llogarive ekonomiko-financiare dhe kërkonin kohën e nevojshme të vendoseshin në kushte normale pune e jetese. Por në të njëjtën kohë, u kërkohej, qysh në momentin e parë, komandave të divizioneve, me të bërë rreshtimin organik dhe me të marrë në dorë flamurin luftarak të divizionit, aty të vihej në gatishmëri të plotë, të ishte i gatshëm me gjithë forcat, mjetet dhe teknikën luftarake t'i përgjigjej flakë për flakë çdo agresioni të mundshëm në kufi, në zonën e mbrojtjes që i ishte ngarkuar.

Me divizionet lindi edhe një vështirësi tjetër, jo e lehtë për Shtabin e Përgjithshëm, pasi nga 9 komanda e shtabe korpusesh, tani do të mbanim në drejtim e komandim 22 komanda e shtabe divizionesh dhe kjo ishte më e vështirë për kohë lufte.

E rëndësishme është se këto njësi operativo-strategjike, për gati 10 vjet, u sistemuan në mënyrë të përkryer në vend-dislokimet e tyre. U pajisën me vendkomanda të kohës së paqes dhe me vendkomanda të kohës së luftës, me

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S VLERËSON KONTRIBUTIN E FORTË TË GJERMANISË

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Rusia nuk po përgatitet për paqe

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, vlerësoi kontributin e konsiderueshëm të Gjermanisë në parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s në një kohë kur lufta e Rusisë në Ukrainë ka shkaktuar sfidat më të mëdha për sigurinë tonë ndër breza. Ai lavdëroi gjithashtu Gjermaninë që është ndër aleatët që ofron ndihmën më të madhe ushtarake, financiare dhe humanitare për Ukrainën, përfshirë sistemet e mbrojtjes ajrore, automjetet e blinduara, artilerinë dhe municionet. Ai e bëri të qartë se “armët nga Gjermania po shpëtojnë jetë në Ukrainë çdo ditë”. Këto deklarata Jens Stoltenberg i bëri gjatë një vizite në Berlin, më 24 janar 2023, ku falënderoi nëpërmjet ministrit të Mbrojtjes Boris Pistorius, Gjermaninë për kontributet e rëndësishme në NATO dhe mbështetjen e fortë për Ukrainën.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi se presidenti Putin po planifikon ofensiva të reja dhe nuk ka indikacione se ai ka ndryshuar qëllimin e tij për të kontrolluar Ukrainën, kështu që e vetmja mënyrë për paqen e qëndrueshme është të bëjë të qartë se Rusia nuk mund të fitojë në fushën e betejës. Stoltenberg vlerësoi njoftimet e fundit nga vendet aleate për të rritur mbështetjen e tyre për Ukrainën, përfshirë këtu dërgimin e tankeve. Stoltenberg tha se “në këtë moment kyç të luftës, ne duhet të ofrojmë sisteme më të rënda dhe më të avancuara për Ukrainën, dhe ne duhet ta bëjmë atë më shpejt”. Ai përshëndeti diskutimin për çështjen e tankeve të betejës, me ministrin Pistorius duke shtuar se “konsultimet mes aleatëve do të vazhdojnë dhe kam besim se shpejti do të kemi një zgjidhje”. Kurse një ditë më parë, Sekretari i Përgjithshëm mori pjesë në Samitin Ekonomik të Welt me drejtuesit e biznesit gjerman në Berlin. Ai diskutoi edhe këtu rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme për Ukrainën, investimet në mbrojtje dhe qëndrueshmërinë shoqërore në një botë më të rrezikshme dhe konkurruese.

Moment kyç, ofrimi i sistemeve më të rënda dhe më të avancuara për Ukrainën

Ndërsa uroi ministrin e ri gjerman të Mbrojtjes për marrjen e pozicionit në një kohë “të luftës të plotë në Evropë” dhe “krijimit të rrezikut më të madh për sigurinë tonë ndër breza”, në konferencën e përbashkët për shtyp Shefi i NATO-s tha se kjo është arsyeja pse lideri gjerman është më i rëndësishëm se kurrë. “Trimëria e forcave ukrainase ka frymëzuar të gjithë botën, por në të njëjtën kohë, ne nuk duhet të nënvlerësojmë Rusinë. Nga ana tjetër presidenti Putin ka dëshmuar se është i gatshëm të paguajë një çmim të lartë për këtë luftë të padrejtë. Ai ka mobilizuar mbi 200 000 trupa dhe po merr armë të reja nga regjime të tjera autoritare, si Irani dhe Koreja e Veriut. Por më e rëndësishmja, ne nuk kemi asnjë tregues se presidenti Putin ka ndryshuar qëllimet e tij”, - theksoi Stoltenberg. “Ai dëshiron të kontrollojë Ukrainën dhe po planifikon ofensiva të reja. E vetmja mënyrë për paqen e qëndrueshme është t'i bëjmë të qartë Putinit se ai nuk do të fitojë në fushën e betejës. Prandaj, ne duhet të sigurojmë sisteme më të rënda dhe më të avancuara në mënyrë



që forcat ukrainase të jenë në gjendje të zbrapsin forcat ruse. Jo vetëm për të mbijetuar, por për të fituar, për të marrë përsëri territorin dhe të mbizotërojnë si një shtet sovran dhe i pavarur në Evropë”. Gjermania është ndër aleatët që ofron ndihmën më të madhe ushtarake, financiare dhe humanitare për Ukrainën. Këtu përfshihen sistemet e mbrojtjes ajrore si Gepard dhe IRIS-T, artileri dhe municione. Së fundmi ajo ka njoftuar gjithashtu dërgimin e sistemeve të avancuara Patriot dhe mjeteve moderne luftarake të këmbësorisë. “Armët nga Gjermania po shpëtojnë jetë në Ukrainë çdo ditë, mbrojtjen e shtëpive, shkollave dhe spitaleve nga sulmet me raketa ruse. Por gjithashtu edhe aleatët e tjerë të NATO-s po rrisin mbështetjen e tyre. Shtetet e Bashkuara njoftuan të premten e kaluar në takimin në Ramstein, një tjetër paketë të konsiderueshme prej 2.5 miliardë dollarësh amerikanë, përfshirë shumë automjete luftarake të këmbësorisë ‘Bradley’ dhe ‘Stryker’, dhe më shumë armë me rreze të gjatë dhe sisteme moderne të mbrojtjes ajrore. Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe aleatët e tjerë kanë njoftuar se do të dorëzojnë tanke. I mirëpres këto njoftime”, - tha Stoltenberg. “Në këtë moment kyç të luftës, ne duhet t'i ofrojmë Ukrainës sisteme më të rënda dhe më të avancuara dhe ne duhet ta bëjmë atë më shpejt”, - tha ai duke njoftuar se e kishin diskutuar në takim çështjen e tankeve të betejës. “Konsultimet mes aleatëve do të vazhdojnë dhe kam besim se shpejti do të kemi një zgjidhje”, - tha Stoltenberg.

“Dhe zgjidhja erdhi në fakt vetëm një ditë më vonë, kur Kancelari gjerman, Olaf Scholz bëri të ditur furnizimin me tanke të tipit ‘Leopard 2’ për Ukrainën në një takim të kabinetit qeveritar të mërkurën, më 25 janar. Pra Gjermania do të furnizojë me tanke ‘Leopard’ Ukrainën. Në një hap të parë do të dërgohen 14 tanke ‘Leopard’ nga rezervat e Bundeswehr. Qëllimi është që bashkë me partnerët e tjerë shpejt të grumbullohen dy batalione tankesh me tanket e tipit

“Leopard 2” për Ukrainën. Së bashku do të dërgohen 90 tanke. Scholz tha se ky vendim është rezultat i këshillimeve intensive që janë zhvilluar me partnerët më të ngushtë evropianë dhe ndërkombëtarë të Gjermanisë. Sipas kancelarit gjerman, “ky vendim ndjek vijën e njohur politike gjermane për të

mbështetur me të gjitha fuqitë ukrainëse”, - thuhet në njoftimin e zëdhënësit të kancelarit gjerman. Dhe gjithashtu për Scholz ka pasur rëndësi që të merrte pjesë në këtë proces edhe partneri më i rëndësishëm i NATO-s, SHBA.

Ministri gjerman i Mbrojtjes Boris Pistorius tha nga ana e tij, më 25 janar, se: “tanket ‘Leopard 2’ mund të jenë operacionale në Ukrainë për rreth tre muaj. Fillimisht do të kryhet trajnimi dhe më pas tanket do të dërgohen në Kiev”, - tha ai. Pistorius tha se vendimi i së mërkurës për të dërguar tanke ‘Leopard 2’ në Ukrainë ishte “historik”. “Gjermania do të diskutojë për dërgesat e mëtejshme të sistemeve të armëve në Ukrainë për sa kohë që lufta të vazhdojë. Megjithatë, është e rëndësishme që ne të mos bëhemi palë në luftë”, - tha Pistorius.

Gjermania luan një rol kyç në NATO me një fond të posaçëm mbrojtës prej 100 miliardë eurosh për avionë të gjeneratës së pestë, helikopterë të rinj, anije, tanke dhe municione. Ajo është tashmë një nga kontribuuesit më të mëdhenj të trupave në misionet dhe operacionet e NATO-s dhe drejton forcat e NATO-s në Lituani. Avionët gjermanë patrollojnë qiellin e aleatëve dhe 15 000 trupa gjermane janë të përkushtuar ndaj forcave të reagimit të shpejtë të NATO-s. Kjo kontribuon ndjeshëm në forcimin e parandalimit dhe mbrojtjes kolektive aleate.

Ndihma për Ukrainën është urgjente, Rusia po përgatitet për ofensiva të reja

Duke folur para gazetarëve, se sa të rëndësishëm dhe vendimtarë për rezultatin e luftës janë tanket e betejës që mund t'i sigurohen Ukrainës, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg tha se kjo jo vetëm që do të mund të zbrapste ofensivat e reja ruse, por edhe Ukraina do të jetë në gjendje të rimarrë territorin për të fituar dhe për të mbizotëruar si një komb sovran i pavarur në Evropë. “Në të njëjtën kohë, ne duhet të kuptojmë se aleatët kanë vendosur tashmë të dorëzojnë tanke luftarake, por gjithashtu të dorëzojnë më shumë automjete të blinduara, duke përfshirë automjete luftarake të këmbësorisë. Pra, ajo që na nevojitet janë pajisje më të rënda, më moderne dhe kjo është pikërisht ajo që aleatët kanë njoftuar tashmë për të ofruar. Gjermania

ka njoftuar të dorëzojë automjete luftarake këmbësorie ‘Marder’, Shtetet e Bashkuara kanë vendosur të dorëzojnë shumë ‘Bradley’ dhe ‘Strikers’ dhe lloje të tjera të automjeteve të blinduara. Kanadaja, aleatët e tjerë gjithashtu po shtojnë lloje të ndryshme automjetesh të blinduara dhe mjete luftarake këmbësorie. Në një bilanc shihet se edhe disa aleatë kanë dorëzuar tashmë tanke luftarake përfshirë disa nga aleatët lindorë. Franca ka njoftuar se do të dorëzojë një tank të lehtë beteje dhe më pas Mbretëria e Bashkuar ka njoftuar se do të dorëzojë tanke moderne ‘Main Battle’, ‘Challenger 2’. Pra, nëse i bashkoni të gjitha këto, njoftimet gjermane, njoftimet nga aleatët e tjerë, janë një gamë e gjerë e llojeve të ndryshme të armaturës për Ukrainën. Ky është një kontribut i madh shtesë për aftësitë luftarake të Ukrainës. Dhe kjo është urgjente, kjo është e rëndësishme sepse Rusia po përgatitet për ofensiva të reja. Ne duhet t'u mundësojmë ukrainasve herët a shpejt të jenë në gjendje t'i zbrapsin ato sulme dhe gjithashtu t'u mundësojmë atyre të rimarrin dhe çlirojnë territorin e tyre”, - tha Stoltenberg dhe theksoi “diskutimin e mirë” në takim për çështjen e tankeve gjermane të betejës. Ai tha se mirëpriste gjithashtu mesazhin e qartë nga ministri se aleatët e tjerë të NATO-s që kanë tanke luftarake ‘Leopard’ janë natyrisht të lirë të identifikojnë tanket luftarake Leopard që mund të jenë të disponueshme për Ukrainën. Për t'i bërë gati ato, por edhe për të filluar stërvitjen e ekuipazheve ukrainase për tanket luftarake”. Sepse siç tha ai pasi të jetë marrë vendimi për dorëzimin e tankeve të betejës, do të duhet pak kohë për të identifikuar, përgatitur dhe trajnuar ekuipazhet ukrainase.

Uniteti perëndimor në mbështetjen e Ukrainës me tanke të betejës

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, kur u pyet nga mediat për unitetin perëndimor lidhur me dërgimin e tankeve në Ukrainë, nënvizoi se aleatët janë në një mendje për mbështetjen dhe se gjëja më e rëndësishme është se kancelari Scholz dhe gjithashtu ministri Pistorius kanë absolutisht të drejtë kur vënë në dukje kontributet e rëndësishme që Gjermania ka dhënë dhe vazhdon t'i japë Ukrainës, “kjo është në fakt një substancë që ka rëndësi” dhe ai tha se kjo bën ndryshimin në fushën e betejës çdo ditë. “Fakti që Gjermania është një nga aleatët që po ofron mbështetjen më të madhe kur bëhet fjalë për artilerinë, municionet, sistemet e avancuara të mbrojtjes ajrore, Gepards, IRIS-T dhe gjithashtu tani mjetet e rënda luftarake të këmbësorisë, ‘Marders’, është e rëndësishme gjithashtu pasi këto janë aftësi të rëndësishme të blinduara që forcojnë ndjeshëm aftësinë luftarake të Ukrainës. Prandaj, jam dakord me kancelarin dhe gjithashtu ministrin që në fakt ne duhet të kujtojmë dhe njohim këto kontribute të rëndësishme gjermane”. Stoltenberg tha se edhe aleatët e tjerë po ofrojnë aftësi të ngjashme, mbrojtje ajrore ose mjete të blinduara, automjete luftarake të këmbësorisë

dhe disa aleatë po ofrojnë gjithashtu tanke luftarake. Lidhur me diskutimin mbi ‘Leopardet’ ai tha se kjo është një lloj pjesë e natyrshme e një politike në zhvillim kur bëhet fjalë saktësisht se çfarë lloj aftësish duhet t'i ofrojmë Ukrainës. “Mendoj se është gjithashtu e rëndësishme të mbrohet kjo hapësirë për konsultime konfidenciale midis aleatëve. Kjo është pjesë e të qenit një Aleancë e 30 aleatëve dhe në fakt ne po punojmë gjithashtu me shumë partnerë siç bëhemi në Ramstein, për t'u konsultuar, për të vlerësuar dhe më pas për të marrë vendime në konsultim të ngushtë”, - tha ai.

Takimi i Grupit të Kontaktit, çfarë u tha në Ramstein

Në takimin e Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes të Ukrainës të udhëhequr nga SHBA-të, mbajtur në Ramstein, Gjermani, dhe kryesuar nga Sekretari Amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg tha se Rusia nuk tregon asnjë shenjë se po përgatitet për paqe, por përkundrazi, po përgatitet për një luftë të gjatë. Prandaj, theksoi ai, është urgjente të rritet më tej mbështetja ushtarake, në mënyrë që Ukraina të fitojë dhe të çlirojë territorin e pushtuar. “Ashtu si shumica e luftërave, kjo ka të ngjarë të përfundojë në tryezën e negociatave, - tha Stoltenberg dhe përsëriti se, - ajo që ndodh në negociatë është e lidhur drejtpërdrejt me atë që ndodh në fushën e betejës, kështu që ne duhet t'i dërgojmë tani më shumë armë ukrainase.” Stoltenberg falënderoi Sekretarin e Mbrojtjes Lloyd Austin për udhëheqjen e Shteteve të Bashkuara në ofrimin e ndihmës shumë të rëndësishme ushtarake për Ukrainën dhe mirëpriti njoftimet e fundit të bëra nga aleatët dhe partnerët e tjerë të NATO-s, përfshirë Gjermaninë, Francën, Kanadanë, Danimarkën, Holandën dhe Suedinë në lidhje me mbrojtjen ajrore, mjetet luftarake të këmbësorisë dhe mjetet e blinduara. Ai gjithashtu përshëndeti që Britania e Madhe, Franca dhe Polonia janë të gatshme të dorëzojnë tanke kryesore luftarake dhe tanke të lehta dhe u bëri thirrje aleatëve dhe partnerëve të ndjekin shembullin e tyre. Sekretari i Përgjithshëm bëri thirrje gjithashtu për furnizime të vazhdueshme me municion, pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje, si dhe trajnime. Në përgjithësi, ai theksoi se vendet e Grupit të Kontaktit po ofrojnë një paketë masive të aftësive luftarake për vetëmbrojtje të Ukrainës dhe se konsultimet do të vazhdojnë. Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi gjithashtu rëndësinë e rritjes së ndihmës ushtarake jo-vdekjeprurëse, duke vënë në dukje se Paketa Gjithpërfshirëse e Ndihmës së NATO-s, po siguron karburant, ushqim, furnizime mjekësore edhe më shumë për Ukrainën. Por nga ana tjetër Sekretari i Përgjithshëm theksoi se aleatët e NATO-s duhet të rrisin prodhimin e armëve dhe municioneve dhe të rimbushin me shpejtësi rezervat. Ai vuri në dukje se Aleanca po punon ngushtë me industrinë për këtë qëllim dhe se prokurimi do të jetë një temë kryesore kur ministrat e mbrojtjes të NATO-s të takohen në shkurt.

NASA: Viti 2022 është viti i pestë më i ngrohtë i regjistruar, trendi i ngrohjes vazhdon

Temperatura mesatare e sipërfaqes së Tokës në vitin 2022 është e lidhur me vitin 2015, si e pesta më e ngrohta e regjistruar, sipas një analize nga NASA. Duke vazhduar trendin afatgjatë të ngrohjes së planetit, temperaturat globale në vitin 2022 ishin 1.6 gradë Fahrenheit (0.89 gradë Celsius) mbi mesataren për periudhën bazë të NASA-s (1951-1980), raportuan shkencëtarët nga Instituti "Goddard" i NASA-s për Studimet Hapësinore (GISS) në Nju Jork.

"Kjo prirje e ngrohjes është alarimante", - tha administratori i NASA-s, Bill Nelson. "Klima jonë që po ngrohet tashmë po bën shenjë: zjarret në pyje po intensifikohen; uraganet po bëhen më të forta; thatësirat po bëjnë kërdinë dhe niveli i detit po rritet. NASA po thëllon angazhimin tonë për të bërë pjesën tonë në adresimin e ndryshimeve klimatike. Observatori ynë i Sistemit Tokësor do të ofrojë të dhëna më të fundit për të mbështetur modelimin, analizën dhe parashikimet tona të klimës për të ndihmuar njerëzimin të përballet me ndryshimin e klimës së planetit tonë."

Nëntë vitet e fundit kanë qenë vitet më të ngrohta që nga fillimi i mbajtjes së të dhënave moderne në 1880. Kjo do të thotë se Toka në vitin 2022 ishte rreth 2 gradë Fahrenheit (ose rreth 1,11 gradë Celsius) më e ngrohtë se mesatarja e fundit të shekullit të 19-të.

"Arsyeja për prirjen e ngrohjes është se aktivitetet njerëzore vazhdojnë të pompojnë sasi të mëdha të gazeve serrë në atmosferë dhe ndikimet planetare afatgjata do të vazhdojnë gjithashtu", - tha Gavin Schmidt, drejtor i GISS, qendra kryesore e NASA-s për modelimin e klimës.

Emetimet e gazeve serrë të nxitura nga njeriu janë rikuperuar pas një rënije jetëshkurtër në vitin 2020 për shkak të pandemisë COVID-19. Kohët e fundit, shkencëtarët e NASA-s, si dhe shkencëtarët ndërkombëtarë, përcaktuan se emetimet e dioksidit të karbonit ishin më të larta të regjistruara në vitin 2022. NASA gjithashtu identifikoi disa super-emetues të metanit - një tjetër gaz i fuqishëm serrë - duke përdorur instrumentin e Hetimit të Burimit Mineral të Puhurit të Sipërfaqes së Tokës që u nis për të Stacioni Ndërkombëtar Hapësinor vitin e kaluar.

Rajoni i Arktikut vazhdon të përjetojë tendencat më të forta të ngrohjes - afër katër herë më shumë se mesatarja globale - sipas hulumtimit GISS të paraqitur në takimin vjetor të 2022 të Unionit Gjeofizik Amerikan, si dhe një studimi të veçantë.

Komunitetet në mbarë botën po përjetojnë ndikime që shkencëtarët i shohin si të lidhura me atmosferën e ngrohjes dhe oqeanin. Ndryshimet klimatike kanë intensifikuar reshjet



dhe stuhitë tropikale, kanë thelluar ashpërsinë e thatësirave dhe kanë rritur ndikimin e valëve të stuhive. Viti i kaluar solli shira të rrëmbyeshëm musonesh që shkatërruan Pakistanin dhe një mega thatësi të vazhdueshme në jugperëndim të SHBA. Në shtator, uragani Ian u bë një nga uraganet më të fortë dhe më të kushtueshëm që goditi SHBA-në kontinentale.

Ndjekja e planetit tonë në ndryshim

Analiza e temperaturës globale të NASA-s është nxjerrë nga të dhënat e mbledhura nga stacionet e motit dhe stacionet kërkimore të Antarktidës, si dhe instrumentet e montuara në anije dhe bova oqeanike. Shkencëtarët e NASA-s i analizojnë këto matje për të llogaritur pasiguritë në të dhëna dhe për të mbajtur metoda të qëndrueshme për llogaritjen e ndryshimeve mesatare globale të temperaturës së sipërfaqes për çdo vit. Këto matje me bazë tokësore të temperaturës së sipërfaqes janë në përputhje me të dhënat satelitore të mbledhura që nga viti 2002 nga "Sounder Atmospheric Infrared" në satelitin "Aqua" të NASA-s dhe me vlerësime të tjera.

NASA përdor periudhën 1951-1980 si bazë për të kuptuar se si temperaturat globale ndryshojnë me kalimin e kohës. Kjo bazë përfshin modele klimatike si "La Niña" dhe "El Niño", si dhe vitet jashtëzakonisht të nxehta ose të ftohta për shkak të faktorëve të tjerë, duke siguruar që ai përfshin ndryshime natyrore në temperaturën e Tokës.

Shumë faktorë mund të ndikojnë në temperaturën mesatare në çdo vit të

caktuar. Për shembull, viti 2022 ishte një nga më të ngrohtët të regjistruar, pavarësisht nga viti i tretë radhazi i kushteve të "La Niña" në Oqeanin Paqësor tropikal. Shkencëtarët e NASA-s vlerësojnë se ndikimi ftohës i "La Niña-s" mund të ketë ulur pak temperaturat globale (rreth 0,11 gradë Fahrenheit ose 0,06 gradë Celsius) nga ajo që do të kishte qenë mesatarja në kushte më tipike të oqeanit.

Një analizë e veçantë, e pavarur nga Administrata Kombëtare Oqeanike dhe Atmosferike (NOAA) arriti në përfundimin se temperatura e sipërfaqes globale për vitin 2022 ishte e gjashta më e larta që nga viti 1880. Shkencëtarët e NOAA përdorin shumë nga të njëjtat të dhëna të papërpunuara të temperaturës në analizën e tyre dhe kanë një periudhë të ndryshme bazë (1901-2000) dhe metodologjinë. Edhe pse renditjet për vite të veçanta mund të ndryshojnë pak nga të dhënat, ato janë në përputhje të gjerë dhe të dyja pasqyrojnë ngrohjen e vazhdueshme afatgjatë.

Të dhënat e plota të NASA-s për temperaturat e sipërfaqes globale deri në vitin 2022, si dhe detajet e plota me kodin se si shkencëtarët e NASA-s kryen analizën, janë të disponueshme publikisht nga GISS.

GISS është një laborator i NASA-s i menaxhuar nga Divizioni i Shkencave të Tokës i Qendrës së Fluturimeve Hapësinore Goddard të agjencisë në Greenbelt, Maryland. Laboratori është i lidhur me Institutin "Tokë" të Universitetit "Columbia" dhe Shkollën e Inxhinierisë dhe Shkencave të Aplikuara në Nju Jork.

Shkencëtarët lëshojnë lazer në qiell për të kontrolluar rrufetë

Rrezet lazer mund të përdoren për të shmangur goditjet e rrufesë nga vendet e cenueshme si aeroportet dhe fermat e erës

Rrufeja godet rreth 40 milionë herë në SHBA çdo vit. Ky fenomen natyror është tmerrësisht i rastësishëm dhe ne mbështetemi kryesisht në rrufetë - një teknologji gati 300-vjeçare - për ta trajtuar atë. Por studiuesit më në fund po punojnë për një zgjidhje të shekullit të 21-të: rrezet lazer.

E pionieruar nga Benjamin Franklin, rrufeja funksionon mirë për të mbrojtur një ndërtesë. Por ai ka vetëm një aftësi të kufizuar për të mbrojtur sipërfaqe më të mëdha toke ose objekte të përhapura si fermat e erës, aeroportet dhe platformat e lëshimit të raketave. Kështu që një ekip shkencëtarësh është përpjekur të përdorë një lazer me fuqi të lartë për të drejtuar goditjet e rrufesë në majë të një mali në Zvicër. Kjo teknikë e "rrufesë lazer" që një ditë mund të shmangë goditjet nga infrastruktura e rëndësishme në shkallë të gjerë. Rezultatet e studimit të ri të studiuesve u publikuan këtë në "Nature Photonics".

"Ajo që ata kanë bërë është shumë mbresëlënëse", - thotë Jerry Moloney, një shkencëtar optik në Universitetin e Arizonës, i cili ishte një nga pionierët e hershëm të këtij aplikacioni lazer, por nuk ishte i përfshirë në studim. "Është një organizim shumë, shumë i sofistikuar".

Rrufeja ndodh kur fërkimi midis pikave të ujit krijon një ngarkesë elektrike statike brenda reve, zakonisht gjatë stuhive. Kjo energji elektrike ndërtohet përpara se të shkarkohet në një shkëndijë gjigante, e cila mund të udhëtojë midis resë dhe tokës, lart ose poshtë, duke ndjekur rrugën e rezistencës më të vogël. Rrufepritësit e rregullt janë bërë prej metali përçues dhe sigurojnë një pikë preferenciale që rufeja të godasë dhe më pas të kanalizojë në mënyrë të sigurt ngarkesën rreth një ndërtese dhe në tokë. Por metali nuk është mënyra e vetme për të tërhequr rrufetë nga objektivat më të cenueshme.

Në eksperimentin e ri, një lazer me fuqi të lartë e kthen një kolonë ajri në një përcjellës elektrik. Kur lëshohet lazeri, molekulat e ajrit në rrugën e rrezes zhvishen nga elektronet e tyre në një proces të quajtur jonizimi. Kjo e transfor-



Një "rufe lazer" e re në veprim.
Foto: TRUMPF/Martin Stollberg

mon ajrin, i cili është normalisht izolues, në një pikë tërheqëse për goditjen e rrufesë - duke krijuar në mënyrë efektive një rufe gjigant, të përkohshëm dhe të kontrollueshëm në qiell mbi zonën që do të mbrohet. Shkencëtarët kishin ëndërruar të ndërtonin rufe lazer për dekada, por eksperimentet e mëparshme kishin dështuar kryesisht. Lazerët që ishin në dispozicion në atë kohë mund të pulsonin vetëm rreth 10 herë në sekondë, shpjegon Aurélien Houard, një fizikan në Ecole Polytechnique në Francë dhe autori i parë i studimit. Kjo shpejtësi është shumë e ngadaltë për të mbajtur një kolonë ajri të jonizuar. Lazeri i ri mund të lëshojë 1000 herë në sekondë, me çdo impuls që zgjat një trilion të sekondës.

"Ju mund të digjni gurë nëse dëshironi me këtë lazer", - thotë Houard. Lazeri ka një fuqi mesatare prej një kilovat (përafërsisht sasia e energjisë elektrike që nevojitet për të funksionuar një furrë ose frigorifer i madh), thotë autori i vjetër i gazetës Jean-Pierre Wolf, një fizikan në Universitetin e Gjenevës.

Studiuesit testuan aftësinë e lazerit të tyre për të tërhequr rrufenë në majë të Sântis, një majë e shquar në Alpet zvicerane që u zgjodh sepse rufeja shpesh godet një kullë telekomunikacioni në majën e saj. Atje, gjatë verës së vitit 2021, ekipi vëzhgoi 16 goditje rrufeje, katër prej të cilave ndodhën ndërsa lazeri ishte ndezur. Dhe në të katër rastet, sensorët - ose një kamerë me shpejtësi të lartë ose një detektor i valëve elektromagnetike me frekuencë të lartë, kapën rrufenë duke ndjekur rrugën e rrezes. Rezultatet janë paraprake tani për tani, dhe autorët shpresojnë të rregullojnë teknikën me më shumë të dhëna nga studimet e ardhshme.

"Hapi tjetër do të jetë më afër aplikacioneve të botës reale, - thotë Wolf, - në thelb duke e ribërë këtë eksperiment, të themi, afër një platforme lëshimi ose afër një aeroporti".

Goditjet e rrufesë në aeroporte janë një "çështje e vazhdueshme" dhe ato jo vetëm që vonojnë fluturimet, por gjithashtu mund të dëmtojnë ose vrasin punonjës dhe udhëtarë, thotë Irene Miller, një asistente profesor e aviacionit në Universitetin e Illinoisit Jugor, i cili nuk ishte i përfshirë në studimin e ri. Shumica e aeroporteve aktualisht mbështeten në sistemet e paralajmërimit të hershëm për të parandaluar aeroplanët të lëvizin ose të ulen kur rreziku i një goditjeje është i lartë.

Mbetet e paqartë se si teknologjia e rrufesë lazer mund të përshtatet me këtë mjedis, sepse edhe lazerët e vegjël që synojnë qiellin janë jashtëzakonisht të rrezikshëm për pilotët. Gjatë eksperimentit të tyre të fundit në majë të malit, studiuesit punuan me autoritetet e aviacionit për të caktuar një zonë ndalim-fluturimi rreth Sântis. Një mënyrë për të adresuar shqetësimet e tilla mund të jetë rregullimi i gjatësisë valore dhe fuqisë së lazerit, dhe autorët e studimit shpresojnë ta eksplorojnë këtë ide në projektet e ardhshme. Për momentin, megjithatë, novacioni i Benjamin Franklin do të duhet të bëjë.

Allison Parshall

"MERCENARËT"

E shkuara, apo e ardhmja e luftës?



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Lufta në Ukrainë po sjell në diskutim edhe një fenomen jo të ri të luftës. Qysh në fillim të agresionit, janë shfaqur dhe kanë treguar gatishmëri mijëra të huaj vullnetarë, të luftojnë për Ukrainën kundër Rusisë, si dhe për Rusinë kundër Ukrainës. Shumë analistë e quajnë luftën me mercenarë si luftë të blerë, luftë të shitur, luftë si biznes, luftë me ushtarë të fatit, luftë me paramilitarë, ushtri private, legjionarë, luftëtarë të lirisë, ose thjesht "mercenarë". Të tjerë i quajnë ushtarë të askujt apo të gjithkujt. Madje disa prej tyre janë nga Rusia që luftojnë kundër Rusisë, duke rikrijuar një panoramë të çuditshme por jo të re të luftës. Armiq që qëndrojnë në të njëjtën anë të barrikadës, patriotë ose tradhtarë në njëjtën kohë, rusë dhe ukrainas që luftojnë kundër rusëve?! Duke qenë se BE-ja aktualisht nuk mund të caktojë zyrtarisht shtetet si sponsorizues të terrorizmit, Parlamenti i bën thirrje BE-së dhe shteteve të saj anëtare që të vendosin kuadrin e duhur ligjor dhe të konsiderojnë shtimin e Rusisë në një listë të tillë. Kjo do të shkaktonte një sërë masash të rëndësishme kufizuese kundër Moskës dhe do të kishte implikime të thella kufizuese për marrëdhëniet e BE-së me Rusinë. Ndërkohë, eurodeputetët, më 23 nëntor 2022, i bëjnë thirrje Këshillit që të përfshijë organizatën paraushtarake ruse 'Grupi Wagner', Regjimentin e 141-të Special të Motorizuar, i njohur gjithashtu si "Kadirovitët" dhe grupe të tjera të armatosura, milici dhe përfaqësues të financuar nga Rusia, në BE si lista terroriste. Fenomeni i luftëtarit me pagesë, ushtarit profesionist, vrasës me pagesë apo mercenar, siç njihet në histori, nuk është i ri. Ky lloj luftëtarit ka shoqëruar luftëtarët që nga lashtësia dhe sot ka marrë emra të tjerë me "patriotikë". Të tillë janë "legjioni i të huajve", "kompani sigurie", "ushtri private" etj. Më i njohuri aktualisht është legjioni francez i themeluar nga mbreti francez Louis-Philippe, më 10 mars 1831. Pas Luftës së Dytë Botërore në Legjionin francez të të huajve, rreth 40% ishin gjermanë. Në këtë legjion marrin pjesë vetëm të huaj, kryejnë operacione vetëm jashtë Francës, ndërsa oficerët janë vetëm francezë. Pra është legjion i huaj por drejtohet vetëm nga francezë, pasi të huajt përparojnë në gradë deri në nënoficer. Fillimisht në legjionin francez pranoheshin edhe kriminelë, vrasës dhe përdhunues ndërsa aktualisht pranohen vetëm persona me kartelë penale të pastër, ose me krime të lehta.

Heronj apo tradhtarë, kjo varet nga pala që i vlerëson. Rusët e vlerësojnë rusin në llogoren ukrainase si tradhtar, ndërsa ukrainasit e dekorojnë të njëj-



tin rus si "hero". Ka pasur disa lloje reagimesh për fenomenin "mercenar" në luftën e Ukrainës me Rusinë, i cili

FENOMENI I LUFTËTARIT ME PAGESË, USHTARIT PROFESIONIST, VRASËS ME PAGESË APO MERCENAR, SIÇ NJIHET NË HISTORI, NUK ËSHTË I RI. KY LLOJ LUFTËTARI KA SHOQËRUAR LUFTËTARËT QË NGA LASHTËSIA DHE SOT KA MARRË EMRA TË TJERË MË "PATRIOTIKË". TË TILLË JANË "LEGJIONI I TË HUAJVE", "KOMPANI SIGURIE", "USHTRI PRIVATE" ETJ.

nuk është aspak i ri; Një reagim është ai i qeverive perëndimore që u japin miratimin e heshtur apo të hapur shtetasve të tyre për të ndihmuar Ukrainën të vetëmbrohet; Ndërsa qeveritë aziatike urdhërojnë shtetasit e tyre të mos bëhen pjesë e luftimeve; Ndërsa qëndrimi i autoriteteve ruse dhe bjelloruse, i kanë denoncuar shtetasit e tyre që luftojnë përkrah Ukrainës, por nga ana tjetër kanë krijuar batalione me mercenarë pro rusë.

Ndër luftëtarët pro-Ukrainës të përfshirë në luftime, ka edhe shtetas rusë dhe bjelloruse që kanë ndihmuar prej vitesh për mbrojtjen e Ukrainës. Ka gjithashtu luftëtarë të mërguar çeçenë, të cilët e kanë kundërshtuar Moskën që nga momenti kur Rusia shkatërroi fushatën e tyre separatiste në Çeçeni, pas dy luftërave të viteve 1990 dhe 2000. Luftëtarët çeçenë të cilët janë në Ukrainë që nga viti 2014, duke u rezistuar forcave ruse dhe separatistëve pro-rusë në rajonin ukrainas Donbas. Përballë këtyre çeçenëve që luftojnë për Ukrainën, është lideri çeçen Ramzan Kodirev që lufton për Rusinë. Sipas gazetës së pavarur bjelloruse "Nasha Niva", në fillim të muajit prill 2022, luftëtarët bjelloruse u shfaqën me emrin e nacionalistit bjellorus të shekullit të 19-të "Kastus Kalinouski". Udhëheqësja opozitare bjelloruse e mërguar në Lituani, Sviatlana Tsikhanouskaya, shpërndau më

13 mars një video në Twitter, të batalionit "Kastus Kalinouski".

Çfarë i shtyn mercenarët të rrezikojnë jetën e tyre, për hir të interesave të njerëzve të tjerë? A është vetëm etja për fitim që tërheq të ashtuquajturat "patat e egra", që shtegojnë drejt sezonit të luftërave apo burrat rrëmbejnë armët me qëllim që të përjetojnë ndjesi të forta dhe të shuajnë etjen e tyre për adrenalinë? Mercenari, është ushtari që hyn në një konflikt të armatosur jo shumë për arsye patriotike, ideologjike, kombëtare apo politike, por kryesisht për përfitime ekonomike dhe para. Gjithmonë në histori ka pasur, ka dhe do të ketë njerëz, që janë më të aftë se të tjerët të zotërojnë dhe përdorin armë. Një njeri i zakonshëm, i pasur, intelektual, i brishtë dhe i pa trajnuar, ka frikë nga vdekja dhe tërhiqet nga lufta, rreziku, adrenalina, dhe dëshira për të vrarë dhe grabitur.

Ndoshta rolin më të madh në kalinin gradual të ushtrisë nga ushtarë në mercenarë profesionistë e ka luajtur edhe stili luks, dembel, frikacak dhe argëtues i skllavopronarëve të djeshëm dhe oligarkëve të sotëm. Kultura fizike për të është vetëm argëtim dhe në garat e forcës dhe ushtrimet e rrezikshme, skllavopronari "i djeshëm dhe oligarku i sotëm" preferon të jetë spektator, jo pjesëmarrës. Ndonjëherë jeta personale, varfëria dhe

rrethanat sociale e detyrojnë një person të marrë armët për para. Ka edhe një kategori tjetër të mençur, pushtetarë të korruptuar dhe të pasur, që i shmangen luftës. Këta janë "bijtë e ku..vave", të cilët me paratë e fituara janë në gjendje t'i paguajnë çmimin e "gjakut", "bijve të nënave", të cilët luftojnë dhe japin jetën për atdheun, që nuk është vetëm i tyre. Nuk janë parë dhe publikuar asnjë rast ku bijtë e politikanëve ose oligarkëve rusë sot, të rrezikojnë jetën për "Nënë Rusi". Për këtë arsye mobilizohen mercenarët, luftëtarët e askujt apo luftëtarët e të gjithëve.

Fenomeni mercenar, është rritur edhe për arsye të ndërgjegjësimit të patriotëve, të varfërve, të cilët falë epokës digjitale, nuk gënjehen më me propagandë, "patriotizmi" dhe "atdhedashurie". Gjatë muajve të fundit pas shpalljes së mobilizimit nga Putin, turma burrash në moshë për luftë, i largohen një lufte që nuk iu përket atyre dhe dynden në vendet kufitare me Rusinë. Çfarë janë këta? dezertorë apo tradhtarë? Jo, në fakt këta nuk janë mercenarë të ushtrisë private të Putinit dhe oligarkëve që kanë dhe duan të vazhdojnë të ngrenë perandorinë e tyre, me gjakun e të mashtruarve dhe fatkeqëve. Falë informimit digjital pa kufij, sot nuk ka më "idiotë të dobishëm" në Rusi, apo dhe në botë, që japin jetën për të mbrojtur pasuritë e të korruptuarave. Fëmijët e të pasurve janë të "bunkerizuar" dhe presin sa të mbarojë lufta, për të punësuar patriotët e "gjakosur" që kanë mundur të mbijetojnë, në bizneset e tyre për të bërë para me "djersën" e tyre.

Fuqia luftarake e mercenarit është trajtuar edhe nga Hollywood me të njëjtin emër, ku aktorët më të njohur të filmave aksion, që vijnë nga shtete, besime, raca, punësohen për të "kryer një punë". Në historinë e luftërave, rasti i parë i njohur i përdorimit të mercenarëve është regjistruar rreth 3500 vjet më parë. Në ushtrinë e Egjiptit, ku ata zinin rreth 50% të gjithë luftëtarëve; Në Betejën e Gaugamelës, 9000 grekë luftuan për Aleksandrin e Madh. Në shekullin III-të para Krishtit u vendos edhe baza ligjore e kohës e njohur si "Marrëveshja me ushtarët mercenarë" të mbretit të Pergamonit Eumeni I. Kjo marrëveshje i përcaktoi qartë kushtet e punës: pagë, pushim 2-mujor pas 10 muajsh shërbimi si dhe pension për jetimët në rast vdekjeje të babait luftëtar (mercenar).

Mercenarët ishin një instrument lufte, dorë e fortë dhe gjakatare i shtypjeve të rebelimeve dhe grindjeve të shtresave të ndryshme civile. Mercenarët nuk kanë atdhe, moral dhe ideologji, ata i shiten gjithkujt që paguan më shumë. Luftëtarët

sllavë për shembull vlerësoheshin veçanërisht si truproje të afta për sulltanët e Turqisë, Sirisë dhe Egjiptit. Këta badigardë formonin një kastë të privilegjuar ushtarake bashkë me jeniçerët dhe mamlukët, që mbronin jetën e sulltanëve me jetën e tyre. Një nga arsytet e fitoreve të mercenarëve ishte tmerri që ata përhapnin te kundërshtarët me mizorinë e tyre. Mercenarët zviceranë për shembull, e kishin të ndaluar të kapnin robër; të gjithë ata që ranë në duart e tyre u vranë. Disfata e mercenarëve erdhi nga dekompozimi i fuqisë së tyre ushtarake, nga paratë. Lakmia për para iu dha mercenarëve guxim të pamatur, gati një çmim për çdo sulm, pavarësisht se ku dhe kur bëhej.

Rekrutimi ishte i vlefshëm vetëm për kohëzgjatjen e luftës, lejoheshin të vishnin edhe rroba dhe të silleshin sipas dëshirës së tyre, ndryshe nga ushtria e rregullt. Perandori Maksimilian shkruan: “Jeta e mercenarëve është e shkurtër, e shurdhër, pa shpresë për jetëgjatësinë, ndaj dhe rrobat e tyre shumëngjyrëshe janë një nga gëzimet e pakta. Le ti veshin ato”. Maksimilian ishte katolik, dhe luftonte kundër princave protestantë të Gjermanisë, por në ushtrinë e tij ai kishte rekrutuar edhe mercenarë protestantë. Zyrtarisht ekzistonte edhe “kod nderi”, por mercenarët e mbanin mend dhe e respektonin atë, për aq kohë sa ishte fitimprurës: biznesi është biznes. Në librin “Taktika” të shkrimtarit ushtarak Enea shkruhet: “Në një ushtri mercenare, kandidati thirret në heshtje, me marrëveshje dhe pa ceremoni. Nëse një mercenar dëshiron të largohet ai mund ta bëjë atë menjëherë, por në rast se dezerton gjatë betejës, ai shitet në tregun e skllëvërve”

Për shekuj me radhë, mercenarët dhe “punëdhënësit” e tyre, megjithëse duke luftuar në të njëjtën anë të barrikadave, mbetën ende armiq. Truket e punëdhënësvë shpesh kanë shkaktuar trazira të vërteta midis luftëtarëve profesionistë. Ndonjëherë mercenarët e merrnin pushtetin dhe këtë e shisnin më vonë, me para. Për shembull, në Sirakuzë dhe Heraklea, mercenarët pasi kishin kryer një grusht shteti nën udhëheqjen e komandantit të tyre, e bënë atë tiran (sundimtar).

Mercenarët janë luftëtarët e duhur të luftërave të fshehta, pasi pikërisht për këtë arsye politikanët rekrutojnë mercenarët, të cilët janë të përsosur për rolin e ushtarëve të luftërave të fshehta. Ndryshe nga një ushtar i rregullt, mercenarët mund të mohohen dhe “sponsorët” të qëndrojnë me duar të “pastra” dhe të ruajnë reputacionin e tyre. Spiunët dhe sabotatorët zgjidhen dhe rekrutohen, me marrëveshje për t’u mohuar. Asnjë shtet nuk i merr në mbrojtje dhe nuk pranon se është pas këtyre sabotatorëve apo spiunëve. Ata thjesht paguhën për punën e kryer dhe marrëdhënia mbaron këtu.

Gjatë luftës së ftohtë në fillim ishte përdorimi që krijoi shumë “ushtri private” nëpërmes kompanive private ushtarake, që në thelb ishin qendra të ligjshme rekrutimi të mercenarëve të kohëve moderne. Rënia e BRSS në vitin 90’ dhe shpërbërja e ushtrisë sovjetike shtruan përpara ushtarakëve profesionistë, pyetjen: “Çfarë duhet bërë me atë që dimë të bëjmë më mirë?” Kishte nga ata që, duke gjykuar se nuk mund të bënin gjë tjetër, vendosën t’i riktheshin profesionit që u kishin mësuar gjithë jetën. Për fat të “mirë” kishte dhe ka luftëra (punë) për të gjithë.



Sipas informacioneve nga media, punonjës të rinj të KGB-së të BRSS, të cilët mbaruan shkollën e spionazhit në 1988, dhe në 1991 shkuan në Afrikën e Jugut “për të punuar” dhe u bënë “ushtarët e parë të fatit”, kështu quheshin mercenarët atje. Duke filluar nga viti 1990, shtypi rus publikonte informacione në lidhje me pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura në territorin e ish-BRSS të mercenarëve nga radhët e ish-oficerëve sovjetikë. Shpejt fama e mercenarëve rusë u dëgjua edhe në Jugosllavi si dhe në vendet e kontinentit afrikan, duke mbjellë panik në kampet armike. Në këtë kohë oficeri i KGB-së Vladimir Putin, sot president i Rusisë, ishte 38 vjeç.

Aktualisht në Ukrainë po lufton grupi

Ukrainë, “Wagner” ka hapur qendra rajonale rekrutimi në 20 qytete ruse, me pagë mujore prej më shumë se 240 000 rubla (ose 3 370 dollarë).

Udhëheqësi i grupit “Wagner”, Yevgeny Prigozhin, i cili është bashkëpunëtori ngushtë i Putinit, raportohet nga radio “Europa e Lirë” se ka rekrutuar mijëra të burgosur rusë për luftën në Ukrainë. Bllokimi në fushëbetje, ia kanë vështirësuar Rusisë mbajtjen e fronteve në pjesën jugore dhe lindore të Ukrainës që ende janë të pushtuara, dhe e kanë detyruar Kremlinin që të shpallë mobilizim dhe gjithnjë e më shumë po varet nga mercenarët apo trupat çeçene për të mbushur radhët. Putin tha, më 4 nëntor 2022, se vazhdojnë përpjekjet për

Beograd, ku po zhvillohen edhe protesta kundër prezencës së tyre nga shoqëria civile serbe. Murale të kafkës së vdekjes, simbol i trupave “Wagner” është vizatuar në mes të Beogradit në kuadër të rekrutimeve për në Ukrainë të rekrutëve serbë.

Rusia madje edhe kundërsulmon nëpërmes ambasadës së saj në Tiranë, më 18 qershor 2022, dhe akuzon shumë vende për mbështetjen e Ukrainës me luftëtarë të huaj.

Sipas Rusisë 150 shqiptarë kanë shkuar në Ukrainë, ndërsa llogaritet të kenë humbur jetën 42 persona, 40 janë larguar ndërsa 68 janë ende në Ukrainë, lajm që u hodh poshtë me të drejtë nga ministrja Xhaçka. Emanuel Bazanji, është i vetmi ish-ushtar shqiptar i bashkuar para pak muajsh komandës së “Legjionit Kombëtar të Gjeorgjisë”. Në Ukrainë ky ish-ushtar shqiptar nderohet, por nëse kthet në Shqipëri ai do dënohet sipas ligjit për pjesëmarrje në luftëra në shtete të huaja, parashikuar nga kodi penal i RSH.

Mediat e pavarura dhe opozita ruse, në tetor 2022, raportojnë se po rekrutohen kriminelë nga burgjet ruse në këmbim të lirisë, me kushtin që të qëndrojnë në frontin e luftës të paktën për 6 muaj. “Wagner” rekruton kryesisht veteranët e ushtrisë që duhet të paguajnë borxhe, që vijnë nga zonat rurale me pak mundësi për të fituar para. Në javët para pushtimit rus të Ukrainës, është zbuluar se mercenarët e Grupit “Wagner” kryen sulme me “flamur të rremë” nga Ukraina lindore, për t’i dhënë Rusisë një pretext për të sulmuar. Grupet mercenare ruse operojnë edhe me emra të tjerë si “The Hawks”, sepse emri “Wagner” është shumë i ndotur tashmë. Kush i financon mercenarët “Wagner”? Dyshohet se agjencia e inteligjencës ushtarake ruse GRU, financon dhe mbikëqyr fshehtas Grupin “Wagner”. Me mercenarët ndonjëherë ndodhin gjëra komike. Pilotët rusë morën pjesë në konfliktin dhjetëmuor midis Etiopisë dhe Eritresë. Gjatë konfliktit, një Su-27 etiopian rrëzoi një MiG-29 Eritrean,

ndërsa të dy pilotët ishin mercenarë rusë.

Gjatë agresionit serb në Kosovë, serbët rekrutuan mercenarë ushtarakë rusë profesionistë kryesisht të ndërlihdjes me radio, si dhe njohës të raketave kundërajrore, që të qëllonin avionët e NATO-s. Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare në Beograd, mercenarët rusë dhe paramilitarët serbë të Bosnjës kanë qenë aktivë në rajonin e Rahovecit në Kosovë, gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s më 1999. Gazetari amerikan Roy Gutman, që punonte për gazetën “Newsday” të Nju-Jorkut, raportonte se kishte parë vullnetarë rusë, në vijat e frontit të vrasjeve që u bënë në fshatrat Krushë e Madhe, Piranë, Samodrazhë, Korishë, Bellacërkë, Pustosellë dhe Drenoc. Në prill të 1999 në afërsi të Pashtrikut, UÇK-ja kishte zënë rob dhe ia dorëzoi NATO-s një mercenar rus. Po ashtu, gazeta e përditshme ruse “Novje Izvestia” raportonte për arritjen e një kufome në Moskë, që ishte trupi i pajetë i rusit 34-vjeçar Fjodor Shulga. Në fund të majit 1999, UÇK-ja ia dorëzoi Kryqit të Kuq kufomën e një mercenari rus, 33-vjeçarit Toger Vitali Bukharin (apo Bulakh). Në Gjakovë, një mercenarë rus pjesëtar i brigadës 549 të motorizuar ka vlarë tre burra shqiptarë, sipas dëshmisë së nënës së shqiptarit që ishte me kombësi ruse, e cila e kishte kuptuar shumë mirë gjuhën e mercenarit. Njësia më famëkeqe luftarake e mercenarëve rusë që luftuan për serbët ishte çeta e “ujqërve”, e përbërë nga ish-ushtarë të forcave speciale. Këto mercenarë paramilitarë, vrisnin, përdhunonin, vidhnin dhe plaçkitnin familjet shqiptare.

Ka rreth 20 mijë denoncime nga gratë e përdhunuara kosovare të vdekuara dhe të gjalla, si viktimat e paramilitarëve serbë dhe rusë. Është therës fakti i fundit ku, më 3 tetor 2022, një gjykatë në Serbi kërkon dëmshpërbllim në mijëra euro të paramilitarëve serbë “ujqërit”, pasi janë diskriminuar në pagesa, gjatë luftës së 1999.



GJATË AGRESIONIT SERB NË KOSOVË, SERBËT REKRUTUAN MERCENARË USHTARAKË RUSË PROFESIONISTË KRYESISHT TË NDËRLIDHJES ME RADIO, SI DHE NJOHËS TË RAKETAVE KUNDËRAJRORE, QË TË QËLLONIN AVIONËT E NATO-S. SIPAS FONDIT PËR TË DREJTËN HUMANITARE NË BEOGRAD, MERCENARËT RUSË DHE PARAMILITARËT SERBË TË BOSNJËS KANË QENË AKTIVË NË RAJONIN E RAHOVECIT NË KOSOVË, GJATË FUSHATËS SË BOMBARDIMEVE TË NATO-S MË 1999.

i njohur i mercenarëve “Wagner” ose siç etiketohet nga media, ushtria private e Putin. BBC-ja ka zbuluar rolin kryesor të një ish-oficeri, 51-vjeçari, Dmitri Utkin, themelues i “Wagner” dhe veteran i luftërave çeçene, një ish-oficer i forcave speciale dhe nënkolonel i GRU-së. Grupi “Wagner” fillimisht hyri në veprim gjatë aneksimit të Krimesë nga Rusia, në vitin 2014, me luftëtarë nga Çeçenia, Siria, Libia etj. Mendohet se mercenarët e “Wagner” janë rreth 1000 mercenarë, të cilët po mbështesin milicët pro-rusë që luftonin për kontrollin e rajoneve të Luhanskut, Donetsk, Zaporizhzhia dhe Kherson. Që nga fillimi i luftës në

rekrutimin e vullnetarëve, pavarësisht shumë treguesve se mobilizimi nuk po vazhdon siç ai dëshiron në Rusi.


Më 5 nëntor 2022, VOA raporton se Komanda ruse e operacionit ka krijuar njësi speciale, të cilat arrestojnë dhe qëllonjë mbi dezertorët, numri i të cilëve sa vjen dhe shtohet. Krijimi dhe përdorimi i një ushtrie mercenare është kundër kushtetutës ruse, megjithatë, “Wagner” i ofron qeverisë ruse një forcë që është ligjërisht e mohueshme. “Wagner” është përfshirë në luftime të përgjakshme jashtë Rusisë, por Kremlin mundet të thotë: “Nuk kanë të bëjnë fare me Ushtrinë ruse”. “Wagner” është shfaqur më 17 janar 2023 edhe në

104 vjet nga vdekja e "Atit të Pavarësisë", Ismail Qemali

104 vite më parë, më 24 janar 1919 kaloi në përjetësi, për të hyrë dhe qëndruar në altarin e pavdekshmërisë së kujtesës sonë kombëtare, personaliteti më i shquar shtetëror, diplomatik dhe shoqëror i lëvizjes kombëtare shqiptare, Babai i Pavarësisë, Themeluesi i shtetit shqiptar dhe figura më e dashur e karizmatike e shqiptarëve, Ismail Qemal Vlorë. Ismail Qemal Vlorë lindi më 24 janar 1844, në Vlorë në familjen e madhe të Vlorajve. Mbiemri i tij Vlorë flet shumë për vendlindjen e tij, për qytetin, familjen e tij patriotike, formimin dhe atdhedashurinë. Familja "Vlorë" është ajo familje e madhe që në breznitë e saj i ka nxjerrë shumë personalitete, me pikën kulmore: Themeluesin e shtetit shqiptar, Ismail Qemal Vlorën, që i kushtoi jetën dhe pasurinë idealit kombëtar. Në vitet e kryengritjeve shqiptare 1910-1912 dhe të Luftërave Ballkanike, veprimtaria atdhetare e Ismail Qemalit u kurorëzua, më 28 nëntor 1912, me shpalljen në Vlorë të Pavarësisë së Shqipërisë. Kuvendi Kombëtar i Vlorës, të cilin ai e ideoi dhe e drejtoi, e zgjodhi Ismail Qemal Vlorën, kryetar të Qeverisë së Përkohshme dhe Ministër të Jashtëm. Politikan, konsekuent i bindjeve të tij liberale dhe tejet përparimtare, të cilat buronin nga shkollimi i tij, njohuritë e gjera që zotëronte për Evropën Perëndimore, njohjen e organizimit shtetëror, sistemit ekonomik, filozofisë politike dhe qytetërimit evropian; si edhe kultura e tij e jashtëzakonshme politike e historike. Biografia dhe veprimtaria e tij politike e diplomatike janë të mahnitshme. Në gati gjysmëshekulli (1860-1908) të veprimtarisë së tij politike e shtetare në Perandorinë Osmane, Ismail Qemali shkëlqeu me të gjithë bagazhin e tij si mendimtar, politikan dhe dijetar. Megjithëse politikan e diplomat në një Perandori, në të cilën sundonte despotizmi oriental, me bindje e me sjellje ai ishte dhe mbeti demokrat liberal. Marrëveshja ishte mjeti i tij politik. Toleranca ishte mënyra e sjelljes së tij, humanizmi ishte etika e tij. Liberalizmi ishte koncepti i tij për shtetin dhe shoqërinë. Mbrojtës i të drejtave të njeriut, që ushtronte pushtetin si pushtet të ndërgjegjes. Ismail Qemal Vlorë ishte një politikan e Burrë Shteti me bindje liberale. Liberalizmi i Ismail Qemalit pati më shumë se një burim. Burimi i parë ishte shkollimi i tij. Në gjimnazin e njohur "Zosimea" të Janinës ai mësoi "...të jetojë – siç thotë vetë – në frymën e lirive të botës së vjetër greke". Aty ai u njoh dhe përvetësoi idetë liberale të Volterit, Zhan-Zhak Rusosë dhe Xhon Lok-ut. Burimi i dytë ishin njohuritë e gjera që zotëronte për Evropën Perëndimore. Ai qëndroi shpesh, diku më shkurt apo diku më gjatë, në Angli, në Francë e në Itali, ku njohu organizimin shtetëror, sistemin ekonomik, filozofinë politike dhe qytetërimin e këtyre vendeve. Burimin e tretë të liberalizmit të Ismail Qemalit e përfaqëson kultura e tij e jashtëzakonshme politike e historike. Ai e dinte se vetëm shtetet demokratike janë shtete historikisht të qëndrueshme. Ai theksonte se "shovinizmi shtetëror, politik, kombëtar dhe fetar është varrtar i shteteve. Çdo perandori e krijuar me shpatë në të njëjtën kohë ka mbjellë edhe farën e shkatërrimit të vet". Për këtë arsye, për rregullimin shtetëror ai e çmonte "forcën morale më të fuqishme se forcën e armatosur" por, natyrisht, forcën morale të mbështetur në ligje demokratike. Gjykimi i tij i qartë, ndershmëria dhe qëndrueshmëria, sjellja e përmbajtur dhe kuraja e gjykimit e bënë sipëror dhe magjepsës personalitetin e tij. Ismail Qemali ishte zotëruesi i situatave dhe zotëri i kohës në të cilën jetoi. Po në saje të cilësive të mësipërme dhe të një vizioni sa patriotik aq edhe largpamës, Ismail Qemali arriti të bëhet prijës i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, themelues i shtetit shqiptar dhe kryeministër i Shqipërisë.

Pa diskutim që kryevepra e tij ngelet themelimi i shtetit shqiptar

Ismail Qemal Vlorë kurrë nuk do t'i keqpërdorte ndjenjat kombëtare për qëllime politike dhe bëri atë që pakkush mund ta bënte: Shpalli Pavarësinë dhe u bë Themeluesi i shtetit të parë shqiptar. Megjithëse ishte shtet ende pa kufij, pa forca të rendit, pa ushtri, pa administratë kombëtare, pa ekonomi, pa financa; pra, shtet pa kushte shteti; Shqipëria e porsakrijuar kishte një garanci të madhe: dinjitetin politik, juridik dhe moral të shtetit, të mishëruar në personalitetin e Tij. Ismail Qemal Vlorë është politikani që e ka dashur aq shumë Shqipërinë, është politikani i ndershëm e idealist, por i braktisur nga bashkëpunëtorët arrivistë, i pa kuptuar nga një pjesë e madhe e bashkëkombësve, i përfolur e i



akuzuar rrejtshëm nga intrigantë. Ismail Qemal Vlorë është i pari politikan shqiptar, që vuri mbi egoizmin Shqipërinë, që mbi keqkuptimin vuri mirësinë, tolerancën e dashurinë; themeloi debatin publik dhe institucionin e dorëheqjes edhe pse nuk meritonte të dorëhiqej. Emri i Ismail Qemalit është shkruar me germa të arta në kujtesën tonë kolektive, si Babai i Pavarësisë dhe Themeluesi i shtetit shqiptar. Ai është protagonist kryesor që bëri përpjekje kolosale politike dhe diplomatike nëpër kancelaritë e Evropës, për të siguruar mbështetjen për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Qeveria e Përkohshme, me në krye Ismail Qemalin, liberalin që ishte i bindur se virtutet shpirtërore duhet të ishin arma kryesore e saj, bëri mrekullinë. Bëri çmos që Shqipëria të shtrihej deri atje deri ku ishin kufijtë e saj etnikë. Edhe pse kjo nuk ndodhi, edhe pse gjysma e kombit ngeli jashtë kufijve të shtetit të porsafornuar shqiptar, historia ishte shkruar tashmë. Në Perugia, më 24 janar 1919, Plaku i Urtë ndërroi jetë (dyshohet i helmuar), në pritje të bisedimeve me qeverinë italiane, për të mbrojtur kufijtë e Shqipërisë. Me rastin e vdekjes së tij, patrioti Mihal Grameno shkroi artikullin shumë prekës po dhe me plot optimizëm: "Mos qani!". Midis të tjerash ai shkruante: "Mos qani dhe mos vajtoni kurrë të kurrës ju o male dhe kodra të Shqipërisë! Ismail Qemali, Plaku i Shqipërisë, nuk ka vdekur dhe kurrë nuk mund të vdesë sa të jetë bota. Në është që ka vdekur Skënderbeu, atëherë le të themi që vdiq edhe Plaku, po jo kurrë! Plaku rron dhe do të rrojë sa të ketë Shqipëria shqiptarë. Mos qani pra ju, o shqiptarë, se rron Plaku, posa që kemi për të gjurmuar Program të tij kombëtarë dhe ay program qëndron: Shqipëria e shqyptarëve! Mos qani pra mos qani!"

Te Ismail Qemali bashkohen në një: Njeriu, Shtetari, Pavdekësia! Emri i Ismail Qemal Vlorës në historinë e popullit shqiptar mbetet përgjithmonë i shënuar si Ati i Kombit, si demokati liberal, që filloi qeverisjen demokratike në jetën kombëtare dhe si personaliteti që dhuntitë e tij politike i përdori në mënyrat më të denja për punët më të rëndësishme të kombit të tij.

Isa Boletini (1864–1916)

Si u vra "Gjenerali me qeleshe të bardhë"

Ai njihet si "gjenerali me qeleshe të bardhë".

Nuk e hiqte kurrë kostumin popullor dhe thuhet se mbante një koburë të fshehur kudo që shkonte.

Ishte njeriu i fortë i Ismail Qemalit dhe organizoi forcat e armatosura për mbrojtjen e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës.

Tregohet se kur Ismail Qemali i ofroi një post ministri, ai ia ktheu: "Jo Ismail, se duhen njerëz të shkolluar", dhe i rekomandoi M. Derallën.

Isa Boletini (1864–1916), pati një nam të madh për guximin dhe arritjet.

Kthesa fatale e jetës së tij duket se nisi një vit pas shpalljes së pavarësisë në Vlorë, me përfshirjen e Kosovës nën Jugosllavinë, sipas vendimeve të Fuqive të Mëdha në takimin e Londrës më 1913.

Legjendat për vrasjen e tij janë të shumta, por një botim i vitit 1971 jep me detaje një skenë krimi, ku duket se janë implikuar autoritetet malazeze dhe diplomatët francezë të kohës.

Në vitin 1915, malazezët pushtojnë Shkodrën. Isa Boletini kërkoi ndihmën e ndërkom-bëtarëve. Francezët ofrohen dhe konsulli i tyre në Shkodër, i thotë Isa Boletinit dhe njerëzve të tij që të shkojnë në Ambasadën Franceze në Cetinë, asokohe kryeqytet i Malit të Zi, nga ku do të merrnin vizë për të shkuar në një vend neutral.

Anglezët, më bujarë, e ftojnë Boletinin ta marrin nën mbrojtje, por nisur nga ligjet e maleve, ai preferon "mikun që i hapi derën i pari".

Boletini dhe njerëzit e tij mbërrijnë në Cetinë dhe më tej bëjnë një vizitë në ambasadën franceze, ku u tregohet një telegram i paraqitur si urdhër i ministrit të Jashtëm francez për t'i nxjerrë në një vend neutral.

Pak orë më pas, në mëngjes, Isa Boletini sheh se shtëpia ku rrinte ishte rrethuar me xhandarë malazezë.

Ai dhe familjarët që e shoqëronin merren dhe dërgohen në Nikshiq, duke u mbajtur gjatë gjithë kohës nën survejim. Thyerja e frontit malazez nga austriakët në të njëjtën periudhë kohe dënon me vdekje përfundimisht Isa Boletinin.

Ushtarët malazezë e shoqërojnë atë bashkë me njerëzit më të afërt në Danilograd dhe më pas në Podgoricë.

Më 23 janar 1916, në ditën kur malazezët po u dorëzonin kryeqytetin pa luftë austriakëve, duket se urdhri për vrasjen e Boletinit dhe njerëzve të tij nuk mund të shtyhej më tej.

Ekzekutimi i besohet një njësie ushtarake që kishte për qëllim mbajtjen e rregullit në qytet, deri në dorëzimin e tij trupave austriake.

Në rrëfimin e Tafilit, nipit të Isa Boletinit, që i mbijetoi ngjarjes, historia do të vinte kështu: "Rreth 80 xhandarë ishin në të dyja anët e urës së Ribnicës, karshi prefekturës, afër kishës katolike. Unë me dy vëllezërit, sipas lajmërimit po ktheheshim për në shtëpi, te axha (Isa).

Patrulla në krye të urës na ndali. Xhandarët pyesin: "Kush asht Isa Boletini?!" Por oficeri ndërhyr duke u thënë: "Mos shtini, nuk është asnjë nga këta!"

Në këtë kohë Isa Boletini, vetë i tetë, kishte hedhur hapat e parë në dërrasat e urës së Ribnicës. Një oficer u kërkoi të dorëzojnë armët, por Isa Boletini kundërshtoi.

I pari që shtie ishte njëfarë Pero Buriqi nga Vasoviçi. Menjëherë flakë për flakë përgjigjet edhe Isa Boletini dhe të tjerët me nga dy revolverë në duar.

Brenda disa minutave, vriten të gjithë, Isa Boletini dhe dy të bijtë, Halili dhe Zahidi, që ishte student në Vjenë, dy nipërit, Jonuzi dhe Halili, Hajdar Selim Radisheva, kunati i Isait, djali i vëllait të Hajdarit, Idriz Bilimi dhe Misin Bala nga Isniqi".

Ata ranë heroikisht për të lënë faqen më të ndritur të historisë shqiptare.

Krenarë për trimërinë dhe atdhedashurinë e bijve më të mirë të këtij kombi!



Shpella e Ramicës që shërbeu si spital partizan gjatë LANÇ-it



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Qendrat mjekësore në luftë

Qendrat e qëndrueshme (stacionare) shërbyen si baza për kalimin në një fazë të re dhe pikërisht në atë të krijimit të spitaleve partizane. Këto qendra, formën e tyre të plotë e morën pas gushtit të vitit 1943, kohë e cila mund të konsiderohet edhe si fillim i kësaj faze të LANÇ-it. Zgjerimi dhe organizimi i ushtrisë partizane ndikoi edhe në zgjerimin dhe përsosjen e shërbimit shëndetësor partizan. Në vijim të këtyre masave organizative, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, i krijuar në Labinot të Elbasanit, më 10 korrik 1943, më 17 gusht të vitit 1943, duke u nisur nga kërkesat dhe nevojat e ngutshme të luftës lëshoi urdhrin e krijimit dhe të organizimit të spitaleve partizane. Ky urdhër dhe një sërë aktesh të tjera përcaktojnë mënyrën e funksionimit të spitaleve partizane. Po kështu u shtruan dhe detyra të veçanta për personelit mjekësor, për mjekët dhe infermierët. Ndërsa në një urdhëresë tjetër të Shtabit të Përgjithshëm përcaktohen me hollësi detyrat e mjekut dhe të infermierit.

Qendër mjekësore e shërbimi mjekësor partizan fillimisht për zonën e Vlorës ka qenë në Shpellën e Ramicës, Smokthinë. Kjo i ka fillimet e veta dhe ka funksionuar si qendër mjekësore nga janari i vitit 1943. Mjeku, dr. Ibrahim Dervishi ka mjekuar dhe shëruar të plagosurit e parë në Luftën e Gjormit, në dhjetor 1942-janar 1943. Më 25 gusht 1943, në Shpellën e Ramicës u krijua i pari Spital Partizan për Zonën e Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër. Këtë shembull e ndoqën edhe të tjerë spitale si në Kuç të Kurveleshit, në fshatin Katund të zonës së Vakëfeve të Korçës, Voskopojë, Hoçisht, Topovë, Nivan, Poliçan të Gjirokastrës, Leshicë e Sipërme në Përmet etj. Spitale partizane u shërbenin Zonave Operative, Grupeve partizane dhe formacioneve të mëdha. Ato ishin vendosur tërësisht në zona të thella e kryesisht të çliuruara e të sigurta, si dhe në pozicione të tilla që lejonin zhvendosjen dhe manovrimin e shpejtë të tyre, me qëllim që në rast nevojë të dislokoheshin në një zonë tjetër më të thellë e më të sigurt. Spitalet ishin të vendosura kryesisht nëpër shtëpitë e patriotëve atdhetarë apo në shkolla e godina të tjera, në ndonjë një rast edhe në çadra fushore apo tenda të thjeshta me degë pylli. Këto shtëpi-spitale, ktheheshin në vende mjekimi e shërimi për qindra e qindra partizanë.

Spitalet partizane të krahinës së Smokthinës, ashtu si në gjithë Shqipërinë, në fillimet e LANÇ-it, mjekimi i partizanëve të plagosur e të sëmurë bëhej me shumë vështirësi. Në fillim të plagosurit lehtë mjekoheshin në çetë e batalion nga luftëtarë që ishin ngarkuar me



shërbimin mjekësor. Të sëmurët apo të plagosurit më rëndë strehoheshin në banesat e fshatarëve për mjekim e kujdes të mëtejshëm. Një qëndrim shembullor kanë mbajtur fshatarët e Smokthinës për sa i përket trajtimit të partizanëve të sëmurë apo të plagosur. Traditat e mjekësisë popullore të kësaj krahine, kujdesi dhe ruajtja e konspiracionit për të mos zbuluar familjet që mbanin partizanë të plagosur, bënë që të kuroheshin me sukses dhjetëra e dhjetëra partizanë e partizane.

Shpella e Ramicës në spital partizan

Në Shpellën e Ramicës në Smokthinë, Vlorë, u ngrit e para infermieri, në janar të vitit 1943, duke u dhënë ndihmën mjekësore partizanëve të plagosur të zonës së Mesaplikut. Më 25 gusht të vitit 1943, kjo infermieri u shndërrua në spitalin e parë partizan të zonës. Shpella e Çine më parë është folur me emrin Shpella e Xhait, pra e Zenjel Hasanit. Shpella ka një hapësirë 300 metra katror, dikur e ndarë mes për mes me një mur guri gati 3 metra i lartë, për të krijuar pjesën e mbrojtur nga shiu. Brenda ajo ndahet me mure shkëmbore, duke krijuar përshtypjen e ndarjes në dhoma. Ka ngushtime e zgjerime me përmasa mesatare 10-15 m. Zgjerimi më i madh ka formën e një kubeje. Lartësia mbi nivelin e detit është 1000 m. Shpella ka përgjithësisht temperaturë konstante e veçanërisht në dimër ndjehet më ngrohtë se sa në ambientin e jashtëm. Shpella, bashkë me më të voglat për rreth, ka qenë një banim i hershëm. Ujin e merr nga kroi i Sarçe, fare afër. Aty janë gjetur ndërtime të vjetra dhe pas gërmimit edhe enë qeramike. Shpella e Hyse, monument kulture, e jashtëzakonshme. Për vlerat dhe shërbimin mbrojtës që ka, maketi i saj, është në Muzeun Kombëtar në Tiranë. Pas asgjësimit të garnizonit gjerman të Drashovicës, në shtator 1943, forcat partizane arritën të marrin gjithë materialin trofe të spitalit fushor si dhe farmacinë e pajisur me medikamente dhe depot me materiale të shumta ushtarake. Gjithashtu robërit italianë u lanë të lirë dhe përgjithësisht ata morën drejtimin e Mesaplikut. Në kontingjentin e forcave italiane të atij garnizoni bënin pjesë edhe 13 mjekë dhe infermierë të cilët iu bashkuan forcave partizane. Në këtë betejë të ashpër u plagosën mbi 40 partizanë, ndërmyjet të cilëve edhe komisar i Zonës së Parë

Operative Vlorë-Gjirokastrë Hysni Kapo, si dhe drejtues të tjerë si Mevlan Dervishi, Arif Hasko, Shefqet Peçi, Jaho Gjoliku, Et'hem Gjinushi, Hito Çako, Manush Myftiu etj.

Personeli i spitalit partizan


Përpara fillimit të Luftës së Drashovicës dhe në zbatim të urdhrin të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së, për krijimin e spitaleve partizane, ishte caktuar edhe qendra ku do të mjekoheshin partizanët e plagosur të zonës dhe kjo ishte Shpella e Ramicës, tashmë e shndërruar në spital partizan. Për këtë fakt dëshmon në kujtime veteranian Shaniko Burhanaj. Ajo shkruan se kur u plagos e dërguan për mjekim në spitalin që ndodhej në guvën e Ramicës. Aty e mjekuan Dr. Ibrahim Dervishi dhe ndihmësja e tij, Drita Kosturi ose Lumja siç e thërrisnin, e cila pas vrasjes së Qemal Stafës ishte dërguar në zonën e Vlorës. "Plagët, - thotë ajo, - i kisha shumë të rënda. Meqë armiku na ndiqte, spitali disa herë u shpërngul". Sipas të dhënave të invalidëve të luftës në zonën e thellë të Kuçit, rezultoi që të kenë qenë edhe qendra të tjera mjekimi që u janë përgjigjur nevojave për mjekimin e partizanëve të plagosur, si p.sh. në Kapinishtë të Kuçit, apo në shtëpinë e Belul Çobos, ku janë mjekuar shumë partizanë. Po kështu në pyllin e Gjenollës që ndodhet afër Kudhësit dhe në Ujë të Zogjve, që është në kufi me Golemin e Kurveleshit, ka funksionuar një qendër mjekësore, në një tjetër shpellë malore, e cila ka ndihmuar shumë, në mënyrë të veçantë, gjatë Operacioneve gjermano-

balliste të Dimrit 1943-1944 dhe të Qeshorit 1944. Këtu janë mjekuar partizanë të plagosur që vinin nga zona e Kurveleshit, Lumi i Vlorës, Bregu, Delvina etj. Në Spitalin e Ramicës kanë shërbyer fillimisht Dr. Ibrahim Dervishi, Dr. Petro Cani i cili më vonë ka shërbyer heroikisht në zonën e Qarkut të Korçës, Shëngjergjit të Tiranës, Zerqanit, të Dibrës e së fundi në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak në Tiranë, Dr. Grigor Konomi, Dr. Grigor Dahu si dhe një mjek Italian. Ky spital pati pajisje të mira e medikamente relativisht të mjaftueshme, pasi ishin materiale të kapura nga italianët në betejën e Drashovicës. Për arsye të rrethanave të luftës, ky spital ka qenë i detyruar të shpërngulej disa herë, madje në disa raste, ta copëzonte aktivitetin e tij dhe, për këtë arsye, në këtë periudhë ndeshemi me mjaft spitale lëvizëse. Në dhjetor të vitit 1943 deri më shkurt të vitit 1944, u hap spitali partizan i Smokthinës në Bodën të Çipinit. Në fillim të Operacionit armik të Dimrit, ky spital iu bashkua spitalit partizan të Kuçit në Kurvelesh. Me futjen e forcave gjermane të ardhura nga Saranda, në fshatin Kuç, spitali partizan i vendosur në këtë fshat, u detyrua të evakuohej dhe në mars të vitit 1944 e gjejmë të bashkuar me spitalin e Poliçanit të Gjirokastrës. Është e kuptueshme që një shpërngulje e tillë në kushtet e dimrit të madh të vitit 1944, si dhe të represionit të egër që ushtronin forcat naziste ka qenë tepër e vështirë.

Spitalet partizane kanë patur që në fillim një karakter kurativo-profilaktik. Kirurgjia e plagëve të luftës, sidomos ato të shkaktuar nga armët e zjarrit, zinte një vend të rëndësishëm në aktivitetin e tyre. Ajo kryej nga kuadro të aftë e të profilizuar, por shpesh edhe nga ish-studentë mjekësie stazhierë, që ende nuk e kishin përfunduar fakultetin dhe me mjete të pakta mjekësore, madje shpesh kur urgjenca e marrjes së masave nuk priste, edhe me mjete të improvizuara rrethanore si sharra, pinca për heqjen e plumbave apo copave të predhave, gërshërë, mjete të mprehta etj.

Për medikamentet, baza kryesore për sigurimin e tyre ishin farmacitë ekzistuese nëpër komuna e qytete me anën e blerjeve të rregullta nga organet kompetente të LANÇ-it, blerjet sistematike jashtë shtetit, kryesisht në Itali nga ana e firmës private që drejtohej nga luftëtari Naum Stralla, i cili gjatë LANÇ-it ka kryer blerje të rregullta medikamentesh. Rrugë tjetër për sigurimin e medikamenteve ishin rrëmbimet masive që u bëheshin spitaleve të ushtrisë armike me anën e aksioneve të njësiteve guerile. Medikamentet janë siguruar gjithashtu dhe nga spitalet apo farmacitë e qyteteve. Në fazat e mëvonshme të LANÇ-it një ndihmë të konsiderueshme për sigurimin e medikamenteve dhe mjeteve mjekësore kanë dhënë ndihmat e aleatëve Anglo-Amerikanë, madje me krijimin e kushteve të përshatshme shumë nga të sëmurët e të plagosurit u transportuan në spitalet e sanatoriumet e tyre, me anën e mjeteve detare në qytetet e çliuruara të Italisë. Gjatë fazave të ndryshme të LANÇ-it shumë punonjës të ndryshëm të shëndetësisë si mjekë, ndihmësmjekë, infermierë, farmacistë, sanitarë, pa marrë parasysh rrezikun që u kanosej, kanë dhënë një kontribut të çmuar në shërbim të anëtarëve të njësiteve guerile, partizanëve të sëmurë apo të plagosur, si dhe popullatës. Kuadri shëndetësor i luftës ndonëse i pakët në numër, e dënoi në fillim pushtimin nazifashist të vendit. Punonjës të këtij shërbimi të rëndësishëm e human të çdo niveli që janë burgosur, internuar apo pushkatuar për shkak të aktivitetit të tyre profesional në shërbim të lirisë dhe pavarësisë së vendit. Mjekët edhe në burje apo në kampet e përqendrimit e kanë ushtruar aktivitetin e tyre mjekësor në shërbim të jetës. Të tillë kanë qenë mjekët Ibrahim Dervishi, Spiro Lito, Mihal Angjeli, të cilët pushtuesi fashist i internoi në ishujt e Italisë, ndërsa mjekët Mihal Konomi, Dhimitër Kutulla në kampet gjermane. Infermiere si Dhimitra Trajani në kampin e Prishtinës, Fato Berberi, Sofie Noti, Dhoksi Dhame në kampin nazist të përqendrimit në Selanik të Greqisë. Jo të pakët kanë qenë mjekët apo punonjësit e tjerë të shëndetësisë të cilët angazhimin e tyre në shërbim të luftës antifashiste e kanë paguar edhe me jetën e tyre, duke rënë Dëshmorë të Atdheut.

Kjo shpellë, me vendim nr. 676, datë 20. 12. 2002 të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare", është shpallur monument kulture.



SHERIF ÇIÇIKU, trajneri i papërsëritshëm i futbollistëve skënderbegas

Janë me qindra futbollistë skënderbegas që kanë bërë karrierë e emër në ekipin e futbollit "Partizani" apo ekipe të tjera të vendit, përfshi dhe jo pak të elitës së futbollit tonë kombëtar që hapat e para të sukseseve, zbulimin e 'shkëndijës' së parë të talentit, kanë një pikë takimi tek dhuntia, përkushtimi dhe puna e Sherif Çiçikut, trajneri i njohur për disa dekada në shkollën "Skënderbej". Pak kush mund ta ketë atë fat që kishte e ka Sherif Çiçiku.

I lindur më 04.12.1939 në Tiranë. Pasioni për lojën e futbollit e kish shfaqur qysh herët, luante shpesh me fëmijët e lagjeve, ashtu si gjithë fëmijët, pa ditur se një ditë, futboli do të bëhej dashuria dhe pasioni i pazëvendësueshëm në jetën e tij. Tashmë, lojërat me top për ne fëmijët, ishin më të shumta e pak më të organizuara. Ecën vitet dhe Sherif Çiçiku i erdhi mosha për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Krahas futbollit kishte pasion dhe mekanikën, dhe dëshirë kishte të bëhej shofer. Kur shkoi ushtar, menjëherë nisi kursin për shofer në Tiranë, pastaj, për shkak se kurset zgjasnin deri më shumë se dy vite, vazhdoi në garnizonin e Korçës. Ishte i shkathët dhe fizikisht i fortë, dhe në drejtimin e automjetit ishte shumë mirë. Në një inspektim të bërë nga ushtarakë madhorë të Ministrisë së Mbrojtjes, një prej tyre, u kërkoi atyre të komandës një shofer. Dhe ky oficer madhor, ishte Luto Haxhi, komandant i shkollës "Skënderbej". Interesohet dhe e transferon ushtar në Tiranë dhe ai bëhet shoferi i tij. "Nuk e dija se kishte qenë një provë ajo, që vetë komandanti më dha një xhip të shkatërruar e më tha nëse mund të gjeja një vend e t'ia rregulloja. Mua, më 'hanin' duart dhe për hekura, e kisha ca mekanikë shokë e shkova në servisën e tyre. E bëmë makinën 'nuse' saqë komandant Luto dhe të tjerët u befasuan. Ishte sikur kishte dalë nga fabrika. Bile, u bënë xhelozë dhe nja dy zëvendësministra të kohës për makinën", - do të shprehej Sherifi.

Ishte viti 1959. Skënderbegasit kishin aktivitete të shumta, përfshi dhe përgatitjen fizike, veçanërisht futbollin. Por dhe sporte të tjera. Ishin bazë e ekipeve të "Partizanit" sportistët skënderbegas. Nisi të luajë me ekipin përfaqësues të shkollës, dhe ishte lojtari i mirë. Nga puna e pasioni, në vitin 1961, bashkë me Bejkush Birçen, ishin trajnerë të ekipit të shkollës "Skënderbej". Meqë Bejkushi, për nevojën të kohës lëvizte (e çonin) tek të rriturit apo dhe në rrethe si në Vlorë apo Durrës si trajner për ndihmë, barra e stërvitjes së ekipit të shkollës i mbeti Sherifit. Dhe sukseset ishin të njëpasnjëshme. Kështu, në 10 kampionate që u zhvilluan mes shkollave të mesme, në 8 prej tyre ekipi i tij doli kampion, duke pasur në finale ekipin e Politeknikut "17 Nëntori", që ishte një shkollë e shumëkërkuar dhe ekipi përfaqësues kishte në përbërje atë kohë 5-6 futbollistë të ekipit tonë kombëtar e të tjerët me ekipe të kryeqytetit që konkurronin në kategorinë e parë.



Ishte një fitore kur ekipi "Skënderbegasit" u fut në kategorinë e dytë, por dhe detyrat për trajnerët, tashmë, ishin më të mëdha. Dilnin vit pas viti kam-



**SHERIF ÇIÇIKU,
I LINDUR MË
04.12.1939 NË TI-
RANË. PASIONI PËR LO-
JËN E FUTBOLLIT E KISH
SHFAQUR QYSH HERËT,
LUANTE SHPESH ME
FËMIJËT E LAGJEVE,
ASHTU SI GJITHË
FËMIJËT, PA DITUR SE
NJË DITË, FUTBOLLI
DO TË BËHEJ
DASHURIA
DHE PASIONI I
PAZËVENDËSUESHËM
NË JETËN E TIJ.**

pion, e sipas rregullit, duhet të futeshin në kategorinë e parë. Por nuk i fusnin. Dhe, pa pyetur njeri, Sherifi i bën një letër dhe ia dërgon Mehmet Shehut, që atëherë ishte Kryeministër dhe Ministër Mbrojtje. Ia shpjegoi në letër të gjitha, duke evidentuar padrejtësinë që iu ishte bërë. Në fakt, ekipi ishte pjesë e një strukture apo institucioni ushtarak, e sipas ligjit, ndonëse si kampion të kategorisë së dytë duhet të hynte në kategorinë e parë, pengesë ishte fakti se nga ushtria në këtë kampionat ishte "Partizani" dhe nuk lejoheshin dy ekipe ushtarakë nga e njëjta ministri, nga ministria e Mbrojtjes. Mehmet Shehu e kishte marrë letrën dhe kishte urdhëruar: "Sqaroheni këtë letër!" Për këtë ngarkohet shoku Maliq Sadushi, që ishte zëvendësministër i Mbrojtjes. Ai shkoi urgjent në shkollë, ku alarmohen komanda. Pas disa debateve, ku u shpjegua dhe shkaku pse nuk e lejonin në kategorinë superiore të vendit, vunë një kusht, që e komunikoi Maliq Sadushi: "Mirë. Do të bëjmë një provë, do bëni një ndeshje me ekipin e Shkollës së Bashkuar të Oficerëve, të shohim rezultatin e pastaj merret vendim!" Megjithatë ishte një kusht jo i lehtë, pasi ekipi kundërshtar ishte i gjithi pothuaj ekipi i parë "Partizani", për ekipin e Sherifit nuk kishte rrugë tjetër.

Në anën e tyre kishte komandën e shkollës, e sidomos masën e skënderbegasve, që gjithmonë i ndiqnin në ndeshjet e tyre.

"Komandanti i shkollës, Mikail

Vaso më tha se çfarë ndihme kërkoja ato 3-4 ditë deri në ditën e ndeshjes. I thash të mos shkonin skënderbegasit në mësim, e të bënim stërvitje. Kështu u bë. Siguroam një fjetinë më vete, ushqimi po ishte i mirë atë kohë, e bënim stërvitje paradite e pasdite. Erdhi dita e ndeshjes. Nuk mendoj se ndonjëherë tjetër stadiumi i Shkollës së Bashkuar të kishte aq tifozë të të dy kampeve sa atë ditë.

Skënderbegasit kishin marrë me vete kapakë tenxhere e bënin tifozllëk nga minuta e parë, duke përplasur kapakët me njeri-tjetrin. Një ndeshje e ashpër, por sportive e me shumë rivalitet. Fituam ne me rezultatin 3:1. Nuk e përmbanim veten nga gëzimi. Më thonë që të kërkoni zëvendësministri Maliq Sadushi në tribunë. Vajta. Më uroi e më tha: "Urime për këtë lojë dhe për fitoren. Paske të drejtë!"

Por ndonëse na u dha e drejta, përsëri nuk na lejuan që të bëheshim pjesë e kategorisë superiore në futboll, me shkakun se nuk lejohen dy ekipe ushtarakë! Por bënë një 'kompensim', që gjithsesi, na jepte shumë pak nga ajo që na takonte.

Mehmet Shehu firmos urdhrin "Sherif Çiçiku emërohet trajner i dytë i ekipit 'Partizani' dhe 10 lojtarë të ekipit të shkollës 'Skënderbej' kalojnë menjëherë në formacionin bazë të ekipit të të rinjve të 'Partizanit!'. Kështu dhe u bë."

Një jetë e tërë, që nga viti 1959 e deri në vitin 1992, kur shkolla

u mbyll ai u mor me futbollistët skënderbegas.

"Kam stërvitur në hapat e parë e më pas disa kohë futbollistë si Foto Andonin, që ka luajtur me ekipin e parë të 'Partizanit' dhe me ekipin 'Vllaznia' të Shkodrës; lojtarët e 'Partizanit' e të ekipit kombëtar Nептун Bajko, Суворов Сефери, Gjergj Thaka, Bashkim Muhedinin, Fatmir Lelin, Vasil Sotiri, Melsi Çobani, Agim Murati, Agim Janku, Hasan Lika, Arjan Ahmeti, legjendën e portës Perlat Musta, Artur Lekbellon e shumë të tjerë. Po nuk mund të rri pa përmendur dhe të tjerë sportistë skënderbegas që kanë luajtur me ekipin e parë të "Partizanit" apo me ekipe të tjera të vendit si: Zamir Podën, Luftar Gurin, Fetah Gurin, Agim Bedinin, Vasil Peçin, Haziz Çeçon, Rober Muhellarin, Shkëlqim Mullajin, Agron Hysin, Fetah Hysin, Agron Hoxhën, Pëllumb Menshin, Bardhyl Kaçoçin, Astrit Kapxhiun, Aleksandër Miculin, Roland Naston, Ajet Abdullain, Kujtim Beqirin e dhjetra të tjerë..."

Në vitin 1992, pushoi së ekzistuari kjo shkollë, e bashkë me ta dhe ekipi i njohur i futbollit. Por ai nuk u nda nga futboli. Nga viti 1992 deri në vitin 2007, kur doli në pension, ishte punonjës në Federatën Shqiptare të Futbollit. Por dhe pranë ekipeve të ndryshme, dhe pse mosha po bën të vetën, ai mbështet e ndihmon talentet e reja.

APLIKO
TANI!

QPR

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT



Forcat e Armatosura kanë nisur rekrutimin për ushtarë/detarë aktivë për vitin 2023. Të gjithë të rinjtë e të rejtat e interesuar, nga mosha 18-27 vjeç, mund të njihen me kriteret e aplikimit të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes:

*<https://www.mod.gov.al/rekrutim/>
Qendra e Personel Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 10.04-09.6.2023, gjithsej 349 kandidatë.*

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri më datën 23 mars 2023.

Kushte pagese dhe trajnimi si asnjëherë më parë.

Lehtësi aplikimi përmes e-Albania.